



ZYRTARE



“300 ditëshi i dytë do të jetë edhe më i mirë se ai që u mbyll”

Pas analizës së parë, vjen parashtrimi për punën e ditëve në vijim

faqe 5

FORCA DETARE

Përfaqësues kompanish turke, vizitë në Komandën e FD

faqe 5

INTERVISTA

Me të parën femër shqiptare, Atashe Ushtarak

faqe 6-7

FORCA AJRORE



Gjeneral Frank Gorenc, vizitë zyrtare në Bazën Ajrore Kuçovë dhe në QKR, Rinas

faqe 5



Gjeneral brigade James J. Grant: Shqiptarët, rezultate të jashtëzakonshme dhe mbreslënëse

“Black Eagle 001” sapo ka ndezur “pishtarin olimpik” të ndryshimit...

Gjeneral Bazo, vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Zhvillohet ceremonia e gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë në New Jersey



Faqe 2-4

NË KËRKIM TË MODELIT TË ARSIMIMIT PROFESIONAL USHTARAK

Modele dhe sisteme të institucioneve të APU-së në vendet e Ballkanit



Përse Ballkani? Në Kohën e Re të historisë në territorin e Ballkanit kanë ndodhur tre luftëra. Dy luftërat e para u bënë gjithashtu shkaktare të luftërave botërore. Lufta e tretë ballkanike ajo në shtetet e ish-Jugosllavisë, sidoqoftë, nuk e ka përcjellë fatin e dy të parave. Në periudhën e luftërave janë konsoliduar ushtritë dhe, në artin e shkencën e luftës janë formuar ushtarakët, të cilët dallojnë dhe shprehin tiparet dhe formimin...

faqe 8-9

NDËRKOMBËTARE

Gjuha e konflikteve dhe parandalimi

faqe 10-11

TERRORIZMI

Problemi afgan dhe fushata kundër rebelimit (COIN)

faqe 12

70 VJETORI

Vlerat dhe rëndësia e “Zonës së Parë Operative”

faqe 14-15

FORCA TOKËSORE



Kursi i 9-të Special në bazën e Pashalimanit, tregues i saktë i kapaciteteve

faqe 5

"Black Eagle 001"



Gjeneral Bazo, vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Gjeneral Bazo: "Black Eagle 001" sapo ka ndezur "pishtarin olimpik" të ndryshimit..

Zhvillohet ceremonia e gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë në New Jersey

Shefi Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtetet e bashkuara të Amerikës. Kjo vizitë u zhvillua si pjesë e bashkëpunimit ushtarak të suksesshëm që FARSH ka me Gardën e New Jersey, si shtet amerikan partner i Shqipërisë. Gjatë kësaj vizite, gjeneral Bazo ka zhvilluar takime me drejtues të Gardës së New Jersey dhe ka vizituar disa nga bazat ushtarake të kësaj garde. Më pas, axhenda e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ka vijuar me marrjen pjesë në ceremoninë e gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë që kanë studiuar në programin pilot në Shkollën e Kandidatëve për Officer të Gardës së New Jersey. "Ky udhëtim që sapo mbaruat këtu nuk është fundi i të gjithë udhëtimit, por është vetëm fillimi për ju. Ju sapo keni ndezur "pishtarin olimpik" të ndryshimit dhe ju duhet të dini se pishtari duhet të rrijë i ndezur



PROCESI

K"Ky udhëtim që sapo mbaruat këtu nuk është fundi i të gjithë udhëtimit, por është vetëm fillimi për ju. Ju sapo keni ndezur "pishtarin olimpik" të ndryshimit dhe ju duhet të dini se pishtari duhet të rrijë i ndezur aq gjatë sa udhëtimi juaj olimpik të vazhdojë. Sfida juaj është që ta mbani flakën ndezur dhe të drejtoni ndryshimin dhe transformimin për të gjithë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ka theksuar gjeneral Bazo në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar të diplomuarve.

STAFI

Kryeredaktor:
Albert
HITOALIAJ

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Alba MUSARAJ

**Redaktore
korrektore:**
Elona SHIMAJ MAKO

Graphic Designer:
Afërdita
HYSAJ

ADRESA:
Ministria e Mbrojtjes,
Rruga e Dibrës

Pjesë nga fjala e gjeneral brigade James J. Grant, shefi i Shtabit të Bashkuar të NJ National Guard, në ceremoninë e gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë në SHBA

"Shqiptarët, rezultate të jashtëzakonshme dhe mbreslënëse"

Kjo gjë është e mrekulueshme, është e jashtëzakonshme. Për aq kohë sa unë kam që merrem procesin e edukimit, për pjesën ushtarake, unë nuk kam parë kurrë një klasë që të gradohet 100% në përfundimin e studimeve. Kështu që, zoti Ambasador, gjeneral Bazo, unë mund t'ju shoh drejt e në dritë të syrit dhe t'ju them se këta 24 djem dhe vajza të reja prezantojnë Shqipërinë në një mënyrë mbreslënëse!

Gjeneral Bazo, sipas pikëpamjes time, ata janë më të mirët dhe më të guximshmit që vendi juaj mund të ofrojë. Ata u testuan e u testuan përsëri... Testi i parë fizik, u kalua 100% dhe ata kaluan çdo pritshmëri. Për sa i përket orientimit me hartë dhe njohjes së terrenit, që janë dy aftësi shumë të vështira për tu zotëruar mirë, kjo klasë, "001", pati një kalueshmëri 100%. Unë nuk kam qenë kurrë dëshmitar i një gjëje të tillë në të gjithë karrierën time... Ruani entuziazmin tuaj dhe mos ndaloni kurrë së mësuari. Secili prej jush ka një karrierë të shkëlqyer përpara. Ju keni bërë miq për kokë e për jetë këtu. Mos na harroni... Zoti bekoftë kombi e madh shqiptar dhe Zoti vazhdoftë të bekojë SHBA!"



aq gjatë sa udhëtimi juaj olimpik të vazhdojë. Sfidat juaj është që ta mbani flakën ndezur dhe të drejtoni ndryshimin dhe transformimin për të gjithë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ka theksuar gjeneral Bazo në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar të diplomuarve.

Gjithashtu, gjeneral Bazo zhvilloi një takim me drejtorin e Shtabit të Bashkuar, gjeneral brigade Grant ku u vlerësua partneriteti i suksesshëm midis dy Forcave të Armatosura gjatë këtyre 2 dekadave të fundit, si performanca e lartë e ushtarakëve shqiptarë që ndoqën programin në Shkollën e Kandidatëve për Oficer të kësaj garde. Gjeneral Grant theksoi se "Mund t'i mësohet kandidati për oficer gjithçka që mund të mësohet nga librat, por nuk mund t'i mësohet "kurajën dhe pasionin". Oficerët shqiptarë i kishin ato brenda vetes".

Programi i Partneritetit të FARSH me Gardës Kombëtare ka filluar në vitin 1993 në përgjigje të ndryshimeve radikale të situatës politiko-ushtarake shqiptare, e cila pasonte ndryshimet globale që ndodhën pas kolapsit të komunizmit dhe shpërbërjes së ish-



Bashkimit Sovjetik. Programi i Partneritetit është një marrëdhënie afatgjatë ndërmjet shtetit të New Jersey dhe Shqipërisë. Kjo marrëdhënie përfshin shumë fusha bashkëpunimi civile dhe ushtarake. Programi i Partneritetit me Gardën Kombëtare të Shtetit të New

Jersey, u konkretizua më së miri në maj të vitit 2001. Ky bashkëpunim ka qenë dhe është i fokusuar në një sërë fushash si:

- Shërbimi i zjarrfikësve
- Veprimet e ekipeve në rast emergjencash

- Ndihmë për ambientin (përfshi atë civil dhe ushtarak)
- Programe për shkëmbimin midis universiteteve (civil dhe ushtarak)
- Binjakëzim midis qyteteve
- Ndihmë për shërbimin mjekësor
- Operacionet për sigurimin e kufijve

dhe luftën kundër trafikëve

Bashkëpunimi ka kulmuar vitet e fundit me trajnimin dhe dërgimin me mision trajnues të Ushtrisë Kombëtare afgane të ekipit të OMLT-1, OMLT-2, OMLT-3, OMLT-4 dhe MAT-5. (OMLT ka ndryshuar emër dhe tani quhet MAT). Aktualisht, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bazuar edhe në bisedimet dypalëshe të zhvilluara në muajin shtator 2012, zyra amerikane për bashkëpunim (ODC) ka iniciuar projektin "Pilot" për përgatitjen e oficerëve të rinj në Shkollën e Kandidatëve për Oficerë, në New Jersey, SHBA.

Konkluzioni i këtij projekti ishte zhvillimi në New Jersey i ceremonisë së gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë që studiojnë në programin pilot në Shkollën e Kandidatëve për Oficer të Gardës së New Jersey. 24 kadetët, kandidatë për oficerë të grupit "Black Eagle 001" janë përzgjedhur nga strukturat e Forcave të Armatosura dhe kanë zhvilluar një program të veçantë stërvitor, ndërsa për 13 javë rresht u përgatitën në Qendrën e Trajnimit të Gardës Kombëtare të New Jersey, SHBA.



Pjesë nga fjala e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në ceremoninë e gradimit të 24 ushtarakëve shqiptarë në SHBA

“Historia po shkruhet tani, në këtë moment”



Jam vërtet i privilegjuar që ndodhem këtu, në këtë ceremoni. Nuk është ekzagjerim nëse e konsiderojmë këtë gjë histori – historia po shkruhet tani, në këtë moment dhe ne të gjithë po bëhemi pjesë e saj. Kjo gjë të cilën ne po e dëshmojmë sot, nuk ndodhi menjëherë, por erdhi falë një programi bashkëpunimi ndërshtetëror që filloi rreth 15 vjet më parë. Të dashur pjesëtarë të “Black Eagle 001” unë do të doja t’ju falënderoj juve si grup. Ju keni bërë që çdo shqiptar dhe sidomos FA shqiptare të jenë krenarë për ju sot. Ju jam thëllësisht mirënjohës pasi me arritjet tuaja, më bëtë të ndjehem krenar te jeni shqiptar, krenar të jem një ushtarak shqiptar. Ju faleminderit shumë!



Të gjithë juve u është dashur që të linit pas familjet. Ka qenë e vështirë për të gjithë ju, por më e vështirë, për Marjanën, e cila ka lënë pas në Shqipëri djalin e saj 3 vjeçar, për Renaldën, e cila ka lënë pas vajzën e saj 5 vjeçare dhe për Hekuranin që pret të bëhet baba pikërisht këto ditë. Nuk ka rëndësi se sa të vështira ishin sfidat për ju. Ato tani kanë përfunduar, por të reja shtrihen para jush e nesh së bashku. Është radha juaj tashmë, që të sillni ndryshimet e pritura, aq shumë të nevojshme për FARSH. Leadershi

nuk është vetëm ajo që mësoni, por ajo jeni në gjendje të përçoni. Kam besim se ju do të keni sukses. Kandidatë për oficerë, ky udhëtim që sapo mbaruat këtu nuk është fundi i të gjithë udhëtimit, por është vetëm fillimi për ju. Ju sapo keni ndezur “pishtarin olimpik” të ndryshimit dhe ju duhet të dini se pishtari duhet të rrijë i ndezur aq gjatë sa udhëtimi juaj olimpik të vazhdojë. Sfidat juaj është

që ta mbani flakën ndezur dhe të drejtoni ndryshimin dhe transformimin për të gjithë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Dhe tani më lejoni që të them diçka në shqip për këta kandidatë për oficerë, krenarisë së trupës sonë që këtej e tutje: Qëndroni me kokën lart! Jini krenar për çka arritët dhe sigurohuni që të bëni krenar gjithë FARSH. Sukseset në karrierën tuaj.





DISKUTOHET BASHKËPUNIMI DETAR TURKO-SHQIPTAR

Përfaqësues të kompanive turke "Mil-Sys" dhe "Istanbul Shipyard", vizitë në Komandën e FD

Komanda e Forcës Detare është vizituar në datën 22 korrik 2014 nga përfaqësues të kompanive turke "Mil-Sys" dhe "Istanbul Shipyard". Ata u pritën nga komandanti i FD, gjeneral brigade Qemal Shkurti dhe oficerë të shtabit të FD. Mbasi i uroi mirëseardhjen ekspertëve turq, gjeneral Shkurti vlerësoi ndihmën dhe bashkëpunimin që populli dhe shteti turk ka afuar për Forcat tona të Armatosura gjatë këtyre viteve. Më pas

përfaqësuesit e kompanive turke prezantuan prodhimet e tyre në fushën e teknologjisë ushtarake, ku vend kryesor zunë anijet e reja të prodhuara nga kantieri "Istanbul Shipyard", veçmas ato të Rojës Bregdetare. Gjatë takimit u diskutua mundësia e bashkëpunimit në këtë fushë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën Detare. Në fund të takimit gjeneral brigade Qemal Shkurti falënderoi specialistët turq për prezantimet dhe mundësitë e afuara nga këto kompani.

Pas analizës së parë, vjen parashtrimi për punën e ditëve në vijim

"300 ditëshi i dytë, më i mirë se ai që u mbyll"

Pavarësisht se është kryer një aktivitet i cili ka vënë në dukje punën e bërë nga institucioni i Ministrisë së Mbrojtjes për 300 ditët e para të qeverisjes, duket se ai ka çelur fillimin e punës për 300 ditëshin e dytë. Në këtë mënyrë, pas analizës së parë, vjen parashtrimi për punën e ditëve në vijim që do të kryejnë strukturat ushtarake.

"Sot është një ditë e bukur për të shijuar motin e mirë dhe stinën aktuale. Por, ne në Ministrinë e Mbrojtjes vendosëm që të mblidhemi të gjithë dhe të diskutojmë mbi të gjitha punën dhe drejtimin e Ministrisë dhe Shtabit të Përgjithshëm. Morali mbi të cilin duhet të jetë e organizuar puna jonë nga pjesa tjetër duhet të na udhëheqë. Misioni ynë është tjetër ndaj na duhet shumë punë. Sot na pret një ditë e gjatë ku do diskutojmë 300 ditëshin e dytë. Padyshim më të mirë nga ai që sapo mbyllëm." - shkruan ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli në faqen e saj në FB, në lidhje me këtë takim pune.



MINISTRJA KODHELI:

"Misioni ynë është tjetër ndaj na duhet shumë punë. Sot na pret një ditë e gjatë ku do diskutojmë 300 ditëshin e dytë. Padyshim më të mirë nga ai që sapo mbyllëm"



FORCA TOKËSORE

Kursi i 9-të Special në bazën e Pashalimanit, tregues i saktë i kapaciteteve

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku, zhvilloi një inspektim të Kursit të 9-të Special në bazën e Pashalimanit, Vlorë. Në këtë kurs marrin pjesë 46 efektivë, të cilët po kryejnë një stërvitje ujore, ditën dhe natën. Kjo stërvitje do të zgjasë 2 javë dhe po zhvillohet me një përkushtim të lartë nga ana e kursantëve. Gjenerali u prit nga grupi i instruktorëve dhe nga komandanti i batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Qazim Hoxha. Në përfundim të inspektimit gjeneral Dushku përshëndeti dhe vlerësoi angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve.



Gjeneral Frank Gorenc, vizitë zyrtare në Bazën Ajrore Kuçovë

NATIMADS, diskutohet gjendja reale e kapaciteteve

Gjeneral Frank Gorenc i shoqëruar nga komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja, zhvilloi një vizitë zyrtare në datën 24 korrik 2014, në Bazën Ajrore të Kuçovës dhe në ambientet e sallës operacionale të Qendrës së Kontroll Raportimit në garnizonin e Rinasit. Gjatë vizitës së zhvilluar në ambientet e Bazës Ajrore, Kuçovë, komandanti i Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja, pasi i uroi mirëseardhjen në këtë bazë, bëri një prezantim të përgjithshëm të misionit, detyrave të Bazës Ajrore të Kuçovës, kapaciteteve operacionale, programet e modernizimit,



statusin e plotësimit të detyrimeve karshi Aleancës, si dhe nevojat për mbështetje në kualifikim dhe standardizim të procedurave të operimit sipas standardeve dhe nevojave që përmbush kjo forcë. Më pas gjatë vizitës së zhvilluar në ambientet e sallës operacionale të Qendrës së Kontroll Raportimit, Komandantit të Komandës Ajrore amerikane për Evropën, Gjeneral Frank Gorenc iu paraqit një përmbledhje e gjendjes aktuale të saj mbi arritjet e kapacitetit të hershëm operacional të NATIMADS, mangësitë aktuale për të arritur kapacitetin e plotë operacional, niveli aktual

i trajnimit të personelit që kryen detyrat në QKR dhe nevojat e menjëhershme për trajnim në funksionet e mbrojtjes ajrore. Gjatë takimit u diskutua mbi projektet e ardhshme për vendosjen e sistemit të ri të komandimit – kontrollit ajror të NATO-s në Qendrën e Kontroll Raportimit, Rinas, dhe nevojat për krijimin dhe modernizimin e sistemit të vëzhgimit ajror dhe të komunikimit Tokë-Ajer-Tokë. Në përfundim të vizitës Gjeneral Gorenc shprehu konsideratat e tij dhe siguroi drejtuesit e Forcës Ajrore për vijimësinë e bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes.

Me të parën femër shqiptare, Atashe Ushtarak

Intervistë me kolonele Razije Mehmetin, e cila së shpejti shkon Atashe Ushtarak në Republikën e Turqisë

Intervistoi: Shefqet Kërçelli

Kolonele Razije Mehmeti, e cila së shpejti shkon e emëruar si Atashe Ushtarak në Republikën e Turqisë, është e para femër e caktuar në detyrën e një Atashe Ushtarak të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga ky fakt gazeta "Ushtria" sjell këtë intervistë, e cila jep disa detaje nga jeta dhe nga karriera e kolonele Mehmetit.

Zonja Kolonele, ju sapo jeni caktuar në detyrën e atasheut ushtarak në Republikën e Turqisë, si e vlerësoni këtë detyrë në shërbim të diplomacisë ushtarake shqiptare?

Së pari falenderoj ministren e Mbrojtjes zonjën Kodheli dhe strukturat e MM për vlerësimin e karrierës sime dhe besimin në këtë detyrë të rëndësishme. Këtë detyrë e quaj nder dhe përgjegjësi njëherësh. Jam krenare që e para femër ushtarake shqiptare krahas uniformës ushtarake vesh dhe atë të diplomates. Pra, një femër që përfaqëson denjësisht autoritetin e interesat ushtarako-diplomatike të vendit të saj në një vend tjetër, një këshilltare e aftë ushtarake për ambasadën tonë në Ankara. Do menaxhoj me kujdes aktivitetet në fushën ushtarake, të diplomacisë së mbrojtjes dhe bashkëpunimit në fushën e sigurisë nëpërmjet programeve të përbashkëta dypalëshe dhe ato në kuadër të NATO-s. Kuptohet që promovimi i arritjeve të FA shqiptare do ketë vend parësor. Pra, si përfaqësuese e Ministrisë së Mbrojtjes dhe vendit tim do përdor aftësitë e mija dhe statusin e diplomatit ushtarak në forcimin e marrëdhënieve bilaterale ushtarake dhe të mbrojtjes me Republikën e Turqisë duke shfrytëzuar kuadrin e miqësisë shekullore mes popujve tanë. Ndërkohë do prezantoj gjerësisht reformat në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë në vendin tonë pas anëtarësimit në NATO, operacionet komplekse në përkrahje të paqes, të emergjencave civile, angazhimet e FA shqiptare në luftën kundër terrorizmit dhe rolin brilant të FA në koalicionin antiterror.

Do donim të dinim diçka rreth karrierës suaj si oficer, ku e ka zanafillën lidhja juaj me uniformën e ushtarakut ?

Kjo lidhet me traditën familjare. Familja ime është vendosur pranë kalasë së Bashtovës në grykëderdhjen e Shkumbinit rreth viteve 20', ashtu si mjaft familje të tjera kosovare të përçezë në forcërisht nga regjimi serb. Gjyshi im Zenun Elazi, ka qenë ushtarak në shtetin e Mbretit Zog dhe më pas familja ime u bë pjesë e rezistencës antifashiste. Nga familja ime dy vëllezërit Veseli dhe Astriti kanë qenë oficerë



rezervistë. Sipas koncepteve ushtarake të sistemit të mëparshëm në çdo qendër të banuar ka pasur repart ushtarak. Dhe ne fëmijëve të fshatit Vilë-Bashtovë na linte mbresa repartit ushtarak Bregdetar ne kodrën Vilë, ku ne shkonim shpesh, por dhe prindërit tanë ishin pjesë e tij. Ndërkohë si gjimnaziste mora pjesë në stërvitjen « Kavaja-86 », ku u dekorova dhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Kështu tradita familjare e gërshtuar me emocionet e jetuara nga kontakti me ushtarakët ndikoi që unë të përcaktoj zgjedhjen time, -profesionin e nderuar të ushtarakut. Thëksoj se arsimimi si ushtarak për femrat kërkon shumë sakrificë dhe mund. Në shkollën e lartë përfundova degën e këmbësorisë. Degë e vështirë, me ngarkesë fizike dhe mendore të lartë. Vlerësoj të gjitha femrat shqiptare që janë arsimuar në shkollat ushtarake për ndjenjën e humanizmit dhe kolektivitetit. Kujtoj me respekt si brezat e mëparshëm ashtu dhe shoqet e mija të kursit, disa prej të cilave vazhdojnë ende karrierën, të tjera vazhdojnë jetën civile, Majlinda Prifti, Arta Driza, Leti Sulaj, Violeta Kopani, Mimoza Pesha, Valbona, etj. Por sfida nuk ishte vetëm shkolla, por jeta, me të papriturat dhe peripecitë e jetës ushtarake. Brezit tonë i takoi ta fillonte punën në kohën e ndryshimeve të viteve 90'. Nuk ishte e lehtë. Fillova në Shkollën e Lirë Ushtarake të Fabrikës së Qelqit, Kavajë. Ne kërkonim stërvitje në një kohë që disiplina binte nga dita në ditë. Kohë të vështira, por si oficerë e re më ndodheshin pranë oficerët me përvojë Mukades Dhima, Rosita Leka dhe Kaliro Papa. Por ngarkesa u shtua kur shërbeva komandante e Kompanisë në Batalionin Artmitraljer të Golemit. Puna direkt me trupën për ne oficeret femra ka vështirësitë e veta, por nqs do të bëhesh oficerë tamam, atje bëhesh.

Nuk të ndahet çanta e shpinës, stërvitja, qitjet. Më pas vijmë detyrat e tjera, specialiste e Sociologjisë në batalion, shefe Sekretarie, shifre e arkivi në Brigadë e Divizion. Në atë kohë u suprimuan dhjetëra reparte, ndaj ngarkesa ishte maksimale. Vërtet kemi pasur specialistë me përvojë që i dhanë drejtim gjithë atyre dokumenteve dhe arkivit të reparteve. U nderova në këtë detyrë duke pasur në krah specialistë si Gëzim Arapi, Flora Moja, etj. Më pas kreuva detyra të ndryshme në Komandën e Forcës Detare dhe këtu me kolegë të nderuar e të aftë. Shefe Sekretarie, me koleget Juliana e Zhuli, shefe Zbulimi me Leonardin, Naimin dhe Edjonin, në planifikim me Dorianin dhe Mirën, e kështu me radhë deri shefe e Degës

së Personel-Arsimimit në Forcë, një detyrë plot përgjegjësi, por ku jam ndjerë më e vlerësuar. Përsëritës klimën e bashkëpunimit dhe sinqeritetit gjatë kryerjes së kësaj detyre si me gjeneralbrigade Qemal Shkurtin ashtu dhe me kolegët e strukturat e tjera të kësaj Force. Një këshillë për pasardhësin tim, mendoj se në të ardhmen duhet promovuar më mirë elita e re ushtarake, brezi i ri i oficerëve detarë, duhen vlerësuar n/officerët, kualifikimi i tyre i vazhdueshëm bashkë me Pr-2. Të gjitha këto në koherencë të plotë me transformimet në FD e FA.

Po për femrat ushtarake keni ndonjë mesazh?

Të jenë vetvetja. Të kërkojnë më



tepër, të kualifikohen më shumë me qëllim që të maten profesionalisht me koleget e tyre të ushtrive në NATO. Në këtë mënyrë atyre mund tu besohen plot detyra brenda strukturave të FA. Aktualisht në FA po bëhet mjaft për barazinë gjinore, ka një klimë miqësore, ndihet mbështetja për femrat ushtarake që nga MM, por dhe këto duhet ta justifikojnë këtë përkrahje me aftësitë e tyre. Personalisht kam kaluar shumë sfida në jetë. Krahas detyrës, punëve në familje nuk e kam ndarë arsimimin dhe përgatitjen si ushtarake karriere. Kurset e kualifikimit e vazhdueshme më kanë ndihmuar të aftësohem profesionalisht në kryerjen e çdo detyre, dhe për detyrën e re të atasheut ushtarak.

Ju keni jo vetëm një traditë ushtaraku, por jeni dhe familje ushtarakësh...

Është e vërtetë. Që në Shkollën e Bashkuar jam njohur me bashkëshortin tim Ilir Mehmeti. Ai ishte në degën e Artilerisë Kundërajrore. Midis rreshtave i hidhnim vjedhurazi vështrime njëri-tjetrit. Por dhe Iliri me shokë nga dritaret hidhnin fjalë





kur kalonte toga jonë. U lidhëm qysh atëherë derisa u martuam në shtator të vitit 1992. Jete e mirëfilltë ushtarakësh. Vështrësitë e profesionit kanë forcuar lidhjen tonë. Do jemi bashkë dhe në Ankara. Po ashtu dhe fëmijët Arbeni dhe Besiana, të cilët do vazhdojnë shkollën atje. Jemi përgatitur të gjithë moralisht, psikologjikisht e shpirtërisht. Sigurisht, duke e pasur familjen pranë do e kem më të lehtë kryerjen e detyrës.

Ju keni shërbyer për shumë vite në Forcën Detare, çfarë mendon se mund ti japësh marrëdhënieve midis FD dhe Flotës Turke?

Gjysmën e karrierës time kam shërbyer në FD. Si pjesë e shtabit kam ndjekur në vijimësi projektet dhe aktivitetet e përbashkëta midis FD dhe Flotës Turke, të cilat kanë përfshirë fusha të ndryshme që nga arsimimi e trajnimi i kuadrove detarë atje, ndihmat logjistike, vizita e stërvitje të përbashkëta, etj. Ndërkohë jam njohur me programin e bashkëpunimit për këtë vit midis FD dhe Flotës Turke, gjithashtu po njihem dhe me programet e Forcave të tjera. Me qetësi e durim do i jap shtytë këtyre projekteve në mënyrë që Forcat tona të

Armatura të përfitojnë sa më shumë nga asistencën e ndihmës ushtarakë turke, në drejtim të arsimimit, modernizimit e rritjes së kapaciteteve operacionale.

Kjo është një detyrë specifike në raport me ato që keni kryer deri tani, a keni bërë parapërgatitje?

Nuk e mendoja se një ditë mund të caktohem në këtë detyrë. Ndaj po shfrytëzoj efektivisht kohën që nga komunikimi i kësaj detyre nga ministria e Mbrojtjes. Është fakt që në programin e qeverisë shqiptare, diplomacia jonë ushtarake është përcaktuar si një instrument i rëndësishëm i politikës së jashtme, veçanërisht asaj ushtarake, e cila ka një funksion strategjik, të specializuar dhe me një profil të konsoliduar tashmë. Në këtë kuptim vlerësoj rolin në rritje të diplomacisë sonë ushtarake, e cila mbas viteve 90' ka vendosur kontakte direkte ose indirekte me të gjitha vendet anëtare të NATO-s. Me sa jam njohur paraprakisht mbas anëtarësimit të vendit tonë në NATO dhe angazhimit të Forcave tona të Armaturës me misionin paqeruajtës dhe të luftës kundër terrorizmit, misioni i atashëve ushtarakë është rritur në

cilësi e përmbajtje. Ndaj unë krahas kontakteve me eprorët e mi të MM, do mbaj kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e NATO-s në vendin tonë. Kam kontaktuar disa ushtarakë shqiptarë që e kanë kryer këtë detyrë më parë, të cilat më kanë dhënë këshilla të vlefshme dhe kam ndarë me ta mendime të ndryshme. Kam freskuar njohuritë në gjuhën angleze, njohuritë e marra në akademi për politikën e mbrojtjes dhe sigurisë, shërbimin e protokollit, arritjet e FA në vite, përpjekjet për transformim dhe modernizim, përmirësimet strukturore, etj. Pjesë e kësaj janë dhe njohuritë në fushën e historisë, kulturës e traditës për dy popujt tanë, të cilat do më duhen gjatë procesit tim të punës. Theksoj se përsa i përket njohurive historike kam shfrytëzuar burimet e përdorura në universitet tona shtetërore. Do përpiqem që brenda afatit tim katërvjeçar në këtë detyrë të realizoj objektivat e shtetit shqiptar e MM në këtë fushë, të jem sa më efikas dhe të arrij më të mirën në marrëdhëniet e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.

Faleminderit e suksese!

NJOFTIM

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Ministrinë e Mbrojtjes janë konfirmuar kurse të tjera shtesë, të cilat zhvillohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Qendrën Marshall, sipas periudhave të cilësuar në listën bashkëlidhur ANEKS A "Lista e përditësuar, e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET", për vitin fiskal 2015. Drejtoria e Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve ka vijuar praktikën për kërkim kandidaturash nga strukturat e FARSH. Me qëllim që ky njoftim të jetë sa më gjithëpërfshirës, lutemi nga ana juaj publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armaturës të listës së përditësuar të kurseve dhe dokumenteve që kërkohen për aplikim për këto kurse. Më poshtë jepet lista dhe përshkrimet e kurseve, e përditësuar, për publikim në faqen zyrtare të MM dhe FA.

Plani arsimor, i përditësuar, për trajnimin e personelit ushtarak dhe civil, në kuadër të programit IMET, për vitin fiskal 2015

WCNs	Titulli i Kursit	Periudha	Përshkrimi i Kursit	Kriteret	Afati
1501	Seminar mbi Sigurinë Rajonale/ "Semiininar on Regional Security (SRS)"	28-Prill - 21-Maj-2015	Përshkrimi: Qëllimi i këtij seminari është që t'i ofrojë pjesëmarrësve zhvillimin e mendimit kritik për krizat si dhe menaxhimin e tyre nëpërmjet mësimave të nxjerra si dhe të ndikimit të faktorëve dhe aktorëve relevant. Kjo do të arrihet duke u fokusuar në dy rajone tradicionale të paqëndrueshme (Ballkani Perëndimor dhe Kaukazi Jugor). Kursi ka qëllimin jo vetëm të përmirësojë njohuritë e pjesëmarrësve me dy rajonet e marrë si shembull, por synon të arrijë gjithashtu një konkluzion të përgjithshëm duke ju referuar kapaciteteve dhe kufizimeve në menaxhimin e krizave. Seminari mbi Sigurinë Rajonale i pajis specialistët e institucioneve të sigurisë kombëtare me një vështrim gjithëpërfshirës mbi dinamikën e sigurisë dhe strategjive për zgjidhjen e konflikteve në rajonet e Europës dhe Euro-Azisë. Kjo bëhet nëpërmjet analizimit të rasteve studimore ku kanë ndodhur krizat rajonale si rezultat i konflikteve të dhunshme. Seminari tre javor në këtë mënyrë ka si synim analizimin e modelit të krizave, impaktin e aktorëve rajonalë, po ashtu edhe efektet e masave të asistencës ndërkombëtare.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada: Major-Kolonel/ Civil Ekuivalent	01 Tetor 2014
1502	Programi i Studimeve të Aplikuara të Sigurisë/ Program in Applied Security Studies (PASS)	25-Shtator - 13-Nentor-2015	Përshkrimi: Fokusi i këtij programi është, të mundësojë edukim të nivelit universitar për çështjet e politikave të sigurisë, të mbrojtjes marrëdhënieve ndërkombëtare dhe fusha të tjera të ngjashme. Ky program është i dizenuar për oficerë të rinj dhe civilë, të të njëjtit nivel, të cilët punojnë në struktura qeveritare dhe agjencitë e sigurisë.	Kriteret: Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë. Grada → Toger-Major/Civil ekuivalent	03 Nentor 2014
1503					
1504	Program on Countering Narcotics and Illicit Trafficking (CNIT)/Programi i Luftës Kundër Trafikut të Lëndëve Narkotike	07-Prill - 03-Shtator-2015	Programi i Luftës Kundër Trafikut të Lëndëve Narkotike është një kurs dy javor i cili fokusohet në kërcënimet kombëtare të sigurisë si rezultat i trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe aktiviteteve kriminale. Ky program ekzaminon metodat kryesore nëpërmjet së cilave organizatat kriminale dhe terroriste zhvillojnë aktivitetin e tyre të paligjshëm në trafikimin e lëndëve narkotike, duke sjellë përfitime të shumave të konsiderueshme parash. Kursi është i dizenuar për personelin e institucioneve të angazhuara në luftën kundër trafikëve, personelin e angazhuar në hartimin e politikave për luftën kundër trafikëve, në zbatimin e legjislacionit në fuqi, institucionet e angazhuara në zbulimin e rasteve të trafikut të lëndëve narkotike, etj.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë Grada → E pa-përcaktuar oficer /civil Të tjera → Kursi është i dizenuar për personelin e institucioneve të angazhuara në luftën kundër trafikëve, personelin e angazhuar në hartimin e politikave për luftën kundër trafikëve, në zbatimin e legjislacionit në fuqi, institucionet e angazhuara në zbulimin e rasteve të trafikut të lëndëve narkotike, etj.	01 Tetor 2014
1505					
1506	Seminar on Transatlantic Civil Security/Seminari për çështjet e sigurisë transatlantike.	08-Qershor - 01-Korrik-2015	Ky seminar trajton mënyrën se si kombet mund të adresojnë çështje kombëtare të sigurisë, të cilat mund të kenë një impakt rajonal dhe ndërkombëtar. Seminari tre javor ekzaminon praktikën me të mira për mundësimin e sigurisë civile, parandalimin, përgatitjen dhe menaxhimin e pasojave që rrjedhin nga krizat dhe fatkeqësitë rajonale. Ky seminar ofrohet për personelin ushtarak dhe civil të cilët kanë përgjegjësi të punës së tyre menaxhimin e çështjeve të sigurisë. Seminari për çështjet e sigurisë transatlantike organizohet në katër module: 1. Kërcënimet dhe rreziqet; 2. Përgatitja dhe mbrojtja; 3. Reagimi dhe rikuperimi; 4. Udhëtime mësimore.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë Grada → Major-Kolonel/Civil ekuivalent	03 Nentor 2014
5203	Seminar me Titullarë "Senior Executive Seminar (SES)"	12-Shtator - 18-Shtator-2015	Përshkrimi: Ky seminar i organizuar nga Qendra Marshall paraqitet si një forum i cili është i dizenuar për të përgatitur pjesëmarrësit e tij, në rang diplomatësh, parlamentarësh, oficerësh madhorë dhe zyrtarë të lartë publikë, në anagazhimin e tyre me çështje delikate të sigurisë globale.	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë Grada → Gjeneral Brigade e lart / Civil ekuivalent	03 Nentor 2014
WCNs	Titulli i Kursit	Periudha	Përshkrimi i Kursit	Kriteret	Afati
5200	International Counterterrorism Fellowship Program/Programi Ndërkombëtar i Luftës kundër Terrorizmit .	E Pa përcaktuar	Përshkrimi: Programi Ndërkombëtar i Luftës kundër Terrorizmit në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes është pjesë e programit rajonal të luftës kundër terrorizmit. Ky program ka një shtrirje akademike 10 mujore dhe iu ofron studentëve një perspektivë strategjike mbi ndryshimet e mjedisit global të sigurisë. Kandidaturat për këtë program duhet të jenë oficerë me gradë N/Kolonel-Kolonel ose civilë ekuivalent, me një eksperiencë pune jo më pak se 15 vjet. Është e këshillueshme pasja e një diplome universitare pasi ky program të ofron diplomë të nivelit master.	Niveli i gjuhës → anglisht (ECL) 90 pikë; TOEFL 83 pikë; Grada → N/Kolonel-Kolonel/Civil ekuivalent	01 Tetor 2014

**Shënim: Të gjitha propozimet duhet të shoqërohen me CV, përshkrim pune dhe formular me të dhënat personale, në gjuhën angleze, sipas formatit të kërkuar, si dhe fotokopje pasaporte. Kandidatet të cilët mendojnë se plotësojnë kriteret për ndjekjen e këtyre kurseve të ndjekin linjen e komandimit dhe nepermjet degeve të personelit të reparteve perkatase të sjellin propozimet në Drejtorinë e Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve.
* Datat dhe kurset e ofruara do të jenë objekt ndryshimi.**

NË KËRKIM TË MODELIT TË ARSIMIMIT PROFESIONAL USHTARAK

Modele dhe sisteme të institucioneve të APU në vendet e Ballkanit

Arsimimi profesional ushtarak dhe akademitë ushtarake

Prof. Dr. Kol. Kristaq Xharo

Përse Ballkani? Në Kohën e Re të historisë në territorin e Ballkanit kanë ndodhur tre luftëra. Dy luftërat e para u bënë gjithashtu shkaktare të luftërave botërore. Lufta e tretë ballkanike ajo në shtetet e ish-Jugosllavisë, sidoqoftë, nuk e ka përcjellë fatin e dy të parave. Në periudhën e luftërave janë konsoliduar ushtritë dhe, në artin e shkencën e luftës janë formuar ushtarakët, të cilët dallojnë dhe shprehin tiparet dhe formimin e akademive ku janë arsimuar dhe trajnuar.

Vështrim i Përgjithshëm

Duke dashur të japim një panoramë të vendeve të Ballkanit, referuar në enciklopedia, sistemin e arsimimit profesional ushtarak e gjejmë me një histori dukshëm të larmishme, me veçori specifike kombëtare, i angazhuar dhe i harmonizuar me trendet europiane. Në vendet e Ballkanit e gjejmë si më poshtë:

Kosova - Është shteti më i ri i Ballkanit dhe duket se është në rrugën e konsolidimit të Forcave të veta të Armatosura e për rrjedhojë edhe të përgatitjes së ushtarakëve të vet. Greqia: Forcat e Armatosura Greke kanë institucione të arsimimit të lartë për çdo armë. Ka një traditë mbi 150 vjeçare. Midis tyre dallohen: Akademinë Ushtarake Evelpidon, e vendosur në Athinë; Akademia Ushtarake e Oficerëve, e vendosur në Selanik; Akademinë Ushtarake Ajrore, e vendosur në Tatoi (Athinë); Akademinë e kadetëve Detare, e vendosur në Pire. Turqia: Tradita e arsimimit turk, mbi 180 vjeçare, kultivohet në: Kara Harp Okulu (Akademia Ushtarake Turke); Akademia e Forcave Ajrore; Akademia e Forcave Detare; Shkolla e lartë Ushtarake Turke; Shkolla e lartë Detare Turke. Serbia, me një traditë mbi 170 vjeçare arsimon ushtarakët e vet në: Shkolla e Mesme Ushtarake; Akademia/Universiteti Ushtarake, Beograd; Kolegji/Akademia e Mbrojtjes

Bullgaria - Integron në mënyrë të shkëlqyer traditën e vet me homologët e vet në NATO. Midis institucioneve të arsimimit shquhen: Shkolla e Mesme Ushtarake; Akademia/Universiteti Ushtarake Kombëtar "Vasil Levski" e themeluar si një shkollë ushtarake në Plovdiv me Fakulteti i Forcave Ajrore, i vendosur në Dolna Mitropoliva; Fakulteti i Mbrojtjes Ajrore dhe Artilerisë, e vendosur në Shumen; Fakulteti Gjitharmësh vendosur në Veliko Tarnova; Akademia Detare "Nikola Vaptsarov" e vendosur në Varna dhe e themeluar në 1881; Kolegji i Shtabit dhe Mbrojtjes "Rakovski" i vendosur në Sofie.



Kadetë grekë

Rumania - ka një traditë të arsimimit ushtarak mbi 180 vjeçare dhe midis shquhen: Shkolla e Mesme Ushtarake; Universiteti Kombëtar i Mbrojtjes "Carl I", në Bukuresht; Akademia Ushtarake Teknike në Bukuresht; Akademia e Forcave Tokësore "Nicolae Balcescu" Sibiu; Akademia e Forcave Ajrore, Brasov; Akademia Detare "Mircea cel Batran" Konstancë.

Kroacia - Akademia Ushtarake Petar Zrinski është institucioni më i lartë i arsimimit të oficerëve në Kroaci. Tashmë Akademia kroate feston 23 vjetorin e krijimit.

Maqedonia - Është me mjaft ambicie duke hedhur themelet e arsimimit ushtarak. Kemi pak informacion për Akademia/Universiteti ushtarak i Maqedonisë

Italia - Pavarësisht se Italia gjeografikisht nuk ndodhet në rajonin e Ballkanit sistemi i saj arsimor është nga më të përparuarit në botë. Nëse do ti referohemi shkrimeve të mëparshme Italia renditej në vendin e 4-ërt në botë midis 10 akademive-modele më të famshme të arsimimit ushtarak. Në Itali arsimimi ushtarak realizohet në disa nivele duke filluar nga shkollat e mesme ushtarake - akademitë ushtarake - universitetet-kolegjet. Institucionet shkollore (vetëm për liceun klasik dhe shkencore duke filluar nga viti i 10 shkollor): Shkolla ushtarake "Nunziatella" e themeluar në 1787 në Napoli; Shkolla Ushtarake "Teulie" në Milano; Shkolla Ushtarake Detare "Morosini" Venecia; Shkolla Ushtarake Ajrore "Dohuet" Firenze; (Viti shkollor 2009-2010 Ka qenë i pari vite në të cilin janë pranuar femra në këto shkolla).

Institucionet në nivele Universiteti: Akademia Ushtarake, Modena; Shkolla e Aplikimit, Torino; Akademia Detare, Livorno; Akademia Ajrore, Pozzuli; Shkolla e Oficerëve të Karabinierisë.

Romë; Akademia e Guardia di Finanza, Bergamo.

Karakteristika të arsimimit dhe modeleve të institucioneve të Arsimit Profesional Ushtarak në Ballkan

Greqia, ka një popullsi me afërsisht 11 milion banorë. Forcat e Armatosura arrijnë në rreth 300 mijë forca (FT rreth 90 mijë, Forcat detare rreth 16 mijë, forcat ajrore në 30 mije dhe Garda në 30 mijë veta. Forcat Rezerve në total shkojnë në rreth 210 mijë vetë dhe këtu nuk përfshihen shërbimi i detyrueshëm në rreth 70 mijë vetë.

Akademia Ushtarake Helene

Arsimimi i Lartë Profesional Ushtarak Grek, për arsimimin e oficerëve të rinj përfshin Akademinë e Forcave Tokësore, Akademinë e Forcave Detare

dhe Akademinë e Forcave Ajrore. Në nivelin e dytë ekzistojnë kolegje të luftës për FT, FD, FA. Duke qenë se objekt i këtij shkrimi janë akademitë ushtarake, pra institucione që diplomojnë oficerët e rinj, jemi ndalur tek Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore Evelpidon. Kujtojmë se kjo akademi u radhit në 10 akademitë më të mira në botë të përzgjedhura nga rrjeti online i akademive dhe kolegjeve ushtarake. Evelpidon Military Academy: "Military School for Aspirant [Officers]", "SSE" është shkolla e kadetëve për oficerë e ushtrisë greke dhe njëkohësisht institucioni arsimor më i vjetër në Greqi. U themelua në vitin 1828 në Napflion. Institucioni u krijua për të siguruar oficerë për ushtrinë greke (këmbësori, tanke, artileri, ndërlidhje,



Akademia Ushtarake Evelpidon

xhenio, dhe aviacion) së bashku me disa korpuse (teknik, transporti, ordincë). Ndryshe nga të tjerët, oficerët në korpusin e ligjshmërisë, mjekësisë, financë dhe auditim janë titulluar si oficer korpusi me përjashtim të infermiereve të cilat janë titulluar nga akademia e infermierisë ushtarake. Akademia, gjithashtu përgatit kadetë në interes të vendeve të tjera aleate. Origjina e motos "Evelpides" në mënyrë figurative shpreh "bartës i shpresave të mëdha", pasazhe që vjen nga historiani Tukidid kur fiset korinthe përshkruan kundërshtarët e tyre athinasit si "aventurier tej fuqisë së tyre, që guxonin mbi një gjykim normal dhe bartnin shpresa të mëdha kur ishin në rrezik..."

Histori

Akademia greke u krijua në vitin 1828 në Napflion, kryeqyteti i parë i Greqisë moderne. Në vitin 1834, akademia i ridislokua në Aegina, dhe në 1837 në qytetin e Pireut. Në vitin 1982, përfundimisht akademia u vendos në qytetin Vari, në periferi të Athinës. Akademia po mbush 200 vjetorin e saj. Përmes historisë së vet



Kadetë serbë



të gjatë, Akademia helene ka qenë pjesë e kryengritjeve apo luftërave të kombit përgjatë historisë. Situata aktuale paraqet karakterin konvencional klasik të shkollave moderne ushtarake. Të titulluarit nga kjo akademi nuk janë vetëm ushtarakë të shquar, por edhe shkencëtarë të niveleve botërore, autorë të famshëm, profesor dhe inxhinierë të universiteteve të fizikës dhe matematikës për aq sa ju deshën që këto universitetet të themeloheshin si institucione shtetërore. Oficerët e parë të marinës dhe forcave ajrore në Luftërat Ballkanike erdhën nga kjo akademi. Akademia është institucioni më i lartë i arsimimit (universitet) dhe vëzhgohet edhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Arsimimi & trajnimi

Kriteret e pranimit: Të jetë me origjinë greke; të ketë mbaruar arsimin e mesëm dhe klasifikimi për sjelljen të jetë "shumë mirë"; të jetë midis 17-21 vjeç; të jetë i gjatë jo më pak se 1.70 cm për djem dhe 1.60 cm për vajza; indeksi trupor 19-27 për meshkuj dhe 18-25 për femra; të jetë i shëndetshëm; të kapërcejë testin akademik (psikologjik,

fizik, i cili është i njëjtë për meshkuj e femra. Kadetët në akademi pranohen mbi bazën performancës shkollore në formatet/ testet që përdoren edhe në universitetet e vendit dhe më pas duke kapërcyer suksesshëm testet fizike dhe psikike. Aplikantët vlerësohen kur kapërcejnë suksesshëm testet me një pikaverazh mbi 80%. Studimet zgjasin 4 vjet dhe pas diplomimit ata fitojnë gradën nëntoger në ushtrinë greke.

Statusi i Akademisë

Akademia Ushtarake Greke është institucion i arsimit të lartë, i akredituar, ekuivalent në dhënie diploma me universitetet. Kurrikula konsiston në disiplina akademike dhe ushtarake. Studimet në akademi zgjasin 4 vjet, të ndara në 8 semestra, 2 për çdo vit akademik. Nga 39 javë të vitit mësimor 2/3 (26) janë akademike dhe 1/3 (13) janë për stërvitje ushtarake Arsimimi akademik përfshin module ushtarake dhe akademike dhe kap deri në 50% të të gjitha kurrikulave. Trajnimi ushtarak përfshin ditë dhe net të trajnimeve fushore. Lëndë si trajnime individuale dhe ushtrime në nivele taktike zhvillohen në koordinim me Korpuset e

ushtrisë helene dhe degët e tjera të Forcave të Armatosura. Stërvitjet ushtarake janë një pjesë vitale e trajnimit të kadetëve dhe mbulojnë 38% të kurrikulave. Përgatitja fizike mbulon 12% të ngarkesës dhe përfshin ecje dhe evente në sporte të ndryshme. Misioni i akademisë është të përgatisë kadetët duke ju afruar trajnim në shkenca dhe arte të ndryshme me pamje për të zgjeruar njohuritë e tyre të përgjithshme dhe duke ju afruar trajnimin e nevojshëm ushtarak për të bërë ata të aftë për të ndjekur Programet speciale të Trajnimit të Ushtrisë helene përpara titullimit, për të kultivuar dhe zhvilluar cilësi dhe karakter që ju kërkohet për një nivel të lartë si oficerë të rinj, cilësi dhe aftësi të nevojshme për tu bërë liderë ushtarakë, me integritet në karakter, dije dhe qëndrueshmëri fizike dhe mendore. Formësimi i drejtuesit. Objektivi kryesor i Akademisë është të formtojë dhe sigurojë për FA oficerë-liderë. Për të realizuar suksesshëm misionin e vet, një oficer-lider modern duhet të ketë cilësitë e mëposhtme:

a. Ai/ajo duhet të jetë ushtarak, që është, burrë/grua me potenciale fizike dhe shpirtërore, me një orientim ekselent në Artin dhe shkencën ushtarake.



b. Një ekspert në çështjet ushtarake si dhe në fusha e tjera të shkencës të nevojshme për të plotësuar misionin e vet.

c. Mbi të gjitha, një lider duhet të jetë një personalitet me cilësi të veçanta humane, i aftë për të drejtuar veten dhe ushtarët e vet në beteja të suksesshme. Dy kualitetet e para për të qenë ushtarakë dhe ekspert kultivohen në akademi përmes arsimimit akademik dhe ushtarak. Kualitetet e një lideri kultivohen përmes trajnimeve ushtarake, të cilat përbëjnë pjesën më të rëndësishme dhe të vështirë të programit sepse lidhen me frymëzimin, karakterin dhe moralin e kadetit; dhe në këtë orientim arsimimi ushtarak dhe akademik i bëjnë apel sa mëndjes po aq dhe trupit të kadetit.

Studentë të huaj

Në këtë akademi studiojnë kadetë nga 15 vende dhe që kapin rreth 20% të numrit të përgjithshëm të kadetëve. Pjesën më të madhe në kadetë të huaj e kap Qipro me rreth 70% të rreth 162 studenteve e më pas Shqipëri, Armeni, Afganistan, Jordani, Kamerun, Qipro, Libi, Kongo, Mali i Zi, Moldova, Burundi, Nigeria, Uganda, Serbia, Siria

Serbia

Akademia Ushtarake, e themeluar në vitin 1850, me mision: "...Identiteti i një ushtaraku profesionist një lider, karakter të fuqishëm, besnik, i trajnuar dhe i përgatitur për sfidat intelektuale dhe etike të hapësirës së profesionit në shërbim të atdheut...mund të arrihet vetëm nëpërmjet sistemit të arsimimit ushtarak..."

Statusi i Akademisë

Akademia ushtarake serbe ka formatin e kolegjit e orientuar për arsimimin ushtarak dhe zhvillimin në karrierë. Akademia është pjesë e sistemit të arsimit të lartë, duke afruar kurrikula të akredituara të nivelit universitar dhe pas-universitar. Ajo ka në përbërje gjithashtu një shkollë të mesme ushtarake, që afron arsimim të mesëm dhe një shkollë të mbrojtjes kombëtare e cila drejton trajnimin e oficerëve. Fasilitetet e akademisë përfshijnë një qendër sportive me pishinë, një stadium me pistë atletike, qendra laboratorike për gjuhët e huaja dhe auditoriume për lektime. Në akademi jepen nivelet e mëposhtme të studimeve: Studime akademike universitare; Studime të thelluara në specialitete; Studime në programe master; Trajnime të specializuara pasuniversitare; Shkolla për oficerët e rezervës; Kërkime të aplikuara për rritjen e kualiteteve të arsimimit, trajnimit dhe kërkimit shkencor, trajnime të stafit pedagogjik dhe përgatitjen e studentëve për punë shkencore.

Studime akademike universitare

Një kualifikim profesional, kompetenca morale, gatishmëri e lartë janë baza për realizimin me sukses të detyrave në komandim të njësisve, në zhvillimin e vazhdueshëm dhe ngritjen e figurës së ushtarakut. Detyra e oficerit është drejtimi dhe komandimi. Qëllimi i përgjithshëm i arsimimit në studimet akademike: është arsimimi i studentëve në profesionin e oficerit, trajnimi për detyrat fillestare në nivelin e komandantit të togës dhe përgatitja për sfidat etike të profesionit, në

përrputhje me misionin e Forcave të Armatosura. Akademia Ushtarake zhvillon programe në 6 fusha kryesore: Menaxhim mbrojtje; Inxhinieri elektronike (ushtarake); inxhinieri mekanike (ushtarake); inxhinieri kimike (ushtarake); aviacion; logjistik. Programet e studimeve kanë një module të cilat ju japin studentëve njohuri të gjera të specialitetit dhe aftësi praktike për profesionin e oficerit. Pas diplomimit, nga programet akademike, studentët shkojnë në pozicione të nëntogerit ose ata vazhdojnë studimet në nivel të programeve master, të organizuara nga Akademia ushtarake. Për këta studentë krahas ndjekjes së leksioneve detyruese, ju kërkohet gjithashtu të marrin certifikatë ndërkombëtare të njohjes së gjuhës së huaj: që mund të jenë edhe

STANAG, por gjithashtu certifikatë ECDL (për aftësitë në kompjuter). Procesi i të mësuarit në akademi konsiston në pjesëmarrje aktive në klasë (leksione, ushtrime, dhe forma të tjera të studimit) si dhe në forma të tjera të të mësuarit (kampuse, stërvitje ushtarake; trajnime në kushte dimërore, ski; ngasje motorësh, fluturime, stërvitje në mjete notuese lumore etj). Procesi i të mësuarit organizohet nga staf akademik i institucionit, por edhe nga lektorë nga universitetet e tjera, apo institucione shkencore, por edhe nga MM dhe SHP. Theksi vihet në implementimin e njohurive dhe aftësive që studentët mund të marrin përmes leksioneve dhe ushtrimeve. Procesi i të mësuarit organizohet në teknikë, pajisje dhe ambiente moderne, laboratorë, kabinete, klasa kompjuterash, dhe internet. Biblioteka me një numër të konsiderueshëm publikimesh krijon mundësi edhe për publikimeve revista apo gazeta që organizon vetë institucioni. Të gjithë programet janë të organizuara në akordancë të plotë me programet të cilat organizohen në akademitë ushtarake europiane.

Studimet master

Studimet në nivel master synojnë të zgjerojnë njohuritë në studimet për të cilat ushtarakët janë diplomuar dhe promovojnë aftësitë në plotësimin e detyrave respektive, njëkohësisht ndikojnë në performancën e punës si një menaxher i diplomuar. Studimet zgjasin një vit ose dy semestra gjatë të cilës ju arrini 60 kredite. Pas përfundimit të suksesshëm, ju jeni një menaxher i diplomuar në profilin përkatës. Kështu, ju keni fituar të gjitha benefitet e kërkua për një pozicion më të mirë në profesionin tuaj dhe keni marrë trajnim të specializuar. Studimet master kryhen në katër programe: Menaxhim mbrojtje; ushtarake: inxhinieri mekanike; ushtarake: inxhinieri elektronike; ushtarake: inxhinieri kimike; studime doktorature.

Akademia ushtarake organizon studime PhD, me synimin për të nxitur studentët për punë dhe kërkim të pavarur shkencor duke arritur nivelet më të larta të arsimimit. Studimet doktoriale realizohen mbi bazën e krediteve dhe ku plotësohen 180 kredite. Tezat e PhD përfaqësojnë fazën finale të programit të studimeve dhe përfaqësojnë një punë ta pavarur, origjinale kërkimore të kandidatit në fusha relevante. Një person që mbron tezën doktoraturës fiton gradën shkencore doktor në fushën respektive. Programet përqendrohen në dy fusha kryesore: Menaxhim mbrojtje; inxhinieri mekanike ushtarake.

Kurse të tjera

Akademia afron kurse në fusha të ndryshme: gjuhë të huaja, inxhinieri marine, menaxhim, taktik, operacione, strategji, logjistik, aviacion, telekomunikacion dhe shkenca kompjuterike, inxhinieri elektronike, kimi ushtarake, armatim-pajisje dhe artileri, mbrojtje ajrore, pajisje të forcave tokësore dhe shkenca sociale. Pjesëmarrësit mund të jenë: Pjesëtarë të institucioneve publike (qendrore apo lokale); pjesëtarë të FA dhe MM si dhe të huaj; pjesëtarë të MB; pjesëtarë të enteve publike apo kompani private; personel civil që punojnë jashtë FA.



Kadete të Akademisë Ushtarake serbe

Gjuha e konflikteve dhe parandalimi

MIMOZA GOLIKJA

Parandalimi i konfliktit të armatosur, mbajtja e paqes dhe rindërtimi e shteteve të dala nga lufta vazhdojnë të mbeten ndër sfidat më të vështira me të cilat përballet komuniteti ndërkombëtar. Thuhet se çdo vit, numri i njerëzve që vdesin në konfliktet e armatosura shkon deri në 250 mijë më së pakti, ku shumica e të cilave ndodhin brenda por dhe midis shteteve. Në harkun kohor të tre viteve të fundit janë vrarë me dhjetëra e qind mijëra njerëz e sidomos në luftërat civile që cilësohen veçanërisht brutale. Konflikti i armatosur dhe pasojat e tij prekin pothuajse çdo aspekt të shoqërisë, rendit dhe ligjit, të drejtat e njeriut, zhvillimin social ekonomik, arsimin, shërbimet bazë shëndetësore dhe të mjedisit. Por “Struktura e paqes në botë nuk mund të jetë vepër e një njeriu, apo një partie, apo një kombi, thotë Franklin Roosevelt, ajo duhet të jetë një paqe e cila mbështetet në përpjekje bashkëpunuese të të gjithë botës”.

Parandalimi i konflikteve, zbutja dhe përgjigja, shqetësime globale

Kostot globale ekonomike të pasigurisë të krijuara nga konfliktet arrijnë në përafërsisht rreth 400 miliardë dollarë çdo vit. Në të njëjtën kohë, parandalimi i konflikteve, zbutja, dhe përgjigja janë shqetësime globale, për shkak se mungesa e stabilitetit shpesh përhapet përtej kufijve dhe shkakton piraterinë, trafikun e drogës, shitjen e armëve të vogla, shfrytëzimin e mjedisit dhe terrorizmin. Ishin mizoritë tronditëse masive në Ruanda dhe në Bosnjë në vitet 1990 ato që bënë që OKB dhe disa organizata rajonale të mandatojnë iniciativat e reja për të adresuar dhunën. Nga ana tjetër reformat e OKB-së përmirësuan aftësinë për të monitoruar zhvillimet politike, mbështetjen e operacioneve paqeruajtëse dhe bashkërendimin e mekanizmave për ndërtimin e paqes. Ndërkohë, marrëveshjet e reja të BE, Unionit Afrikan (BA), Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), si dhe organizata të tjera rajonale kanë rritur përgjegjshmërinë në destabilizim dhe në dhunën në rajonet e tyre. Thuhet se këto instrumente ndërkombëtare kanë pasur një rekord “të përzier” të suksesit, pasi në shumë raste, në institucionet ndërkombëtare të ngarkuara me nxitjen e paqes dhe stabilitetit mungon konsensusi politik dhe burimet financiare për të përmbushur mandatet e tyre dhe shpesh mbeten pas dore parandalime të konflikteve si një mjet kritik për menaxhimin e konflikteve të armatosura. Burimet tregojnë se shumica e përpjekjeve paqeruajtëse ende kanë fuqi të pamjaftueshme, para dhe pajisje për të përmbushur mandatet e tyre dhe komuniteti ndërkombëtar shpesh nuk arrin për të nxitur paqen dhe shëruar vendet e shkatërruara nga lufta. Por në vitet e fundit, institucionet shumëpalëshe dhe



qeveritë i kanë kushtuar vëmendje në rritje sfidatve të parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, ruajtjen e paqes, dhe ndërtimin e paqes në postconflict. Madje pjesërisht si rezultat i përpjekjeve të tilla, ndërshtetërore dhe konfliktet brenda shtetërore kanë rënë me mbi 60 për qind nga 1992 gjatë dy dekadave të fundit, nga të cilat konfliktet e profilit të lartë në Siri, Irak dhe Afganistan rezultojnë se kanë konsumuar pjesën më të madhe të vëmendjes dhe të burimeve ndërkombëtare edhe pse duket nganjëherë sikur instrumentet ndërkombëtare të dizajnuara për të parandaluar shpërthimin e konflikteve apo fund luftimeve mbeten të ngathët në kohë dhe të paefektshëm. Në aktorët më të rëndësishëm në dhënien fund të konfliktit, OKB-ja është ajo që luan rol të domosdoshëm, e krijuar në vitin 1945 për të “shpëtuar brezat e ardhshëm nga kamxhiku i luftës,” gëzon legjitimitet universal dhe statusin ligjor, në sajë të statutit të saj. Madje në një kontekst pas Luftës së Ftohtë në vitin 1992, sekretari i përgjithshëm i OKB-së Boutros Boutros-Ghali lëshoi një agjendë për Paqe, ku paraqiti konceptin e postconflictit, ndërtimin e paqes të mbështetur në zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e rikthimit të dhunës. Megjithatë, për shkak të dallimeve të thella politike dhe ideologjike ndërmjet anëtarëve të tij të përhershëm, veprimet e Këshillit të Sigurimit për t’iu përgjigjur krizave shpesh kanë dhënë një panoramë të ngadalshme, për vënien në veprim të departamenteve të krijuara për të menaxhuar një konflikt, për të mbështetur në terren, për parandalimin, zbutjen dhe përgjigjet.

Sanksionet, shënjestrim për dhënien fund apo penguar dhunën

Konflikti i fundit në Ukrainë dhe dhuna midis palëve çoi në përshakalëzime të njëpasnjëshme që pasuan me votimin në Krime ku sipas njoftimit, rezultatet ishin të thella, 97 për qind e pjesëmarrësve votuan për t’u bashkuar me Rusinë. Madje pjesëmarrja në


votime u njoftua të ishte mbi 80 për qind. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e cilësuan referendumin si të paligjshëm dhe në shkëlqje të kushtetutës së Ukrainës, Uashingtoni dhe Brukseli reagon menjëherë, duke vendosur kufizime udhëtimi dhe sanksione ekonomike për 28 zyrtarë rusë dhe 4 ukrainas. Kjo situatë pasoi me të tjera që ende vazhdojnë. Nëse kthehemi pas në kohë në prag të gjenocidit dhe mizorive në Ruanda dhe Bosnjë në vitet 1990, OKB-ja zbatoi një sërë iniciativash të reja dhe reformash për të përmirësuar menaxhimin e konfliktit, që përfshinin sanksione në shënjestër për të penguar dhunën apo dhënien fund të saj, panele të ekspertëve për të monitoruar efektivitetin e sanksioneve të synuara kundrejt vjedhësve të paqes, si dhe rritje në përdorimin e të dërguarve të veçantë dhe përfaqësuesve. Këto janë përparime që kanë ndihmuar dhe ndihmojnë për të zbutur konfliktin ndër dhe brenda shteteve. Në vitin 2005, Komisioni për ndërtimin e paqes (PBC) u krijua për të nxitur strategji të integruara për paqe dhe shërim të qëndrueshëm si pasojë e konfliktit të armatosur, duke siguruar burime dhe koordinimin e aktorëve politikë, të sigurisë dhe të zhvillimit. Nga ana tjetër ishin dhe organizatat e tjera rajonale si Bashkimi Afrikan, NATO, BE, Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN), dhe Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), për t’iu përgjigjur më mirë dhunës. Për shembull në vitet e fundit NATO në Kosovë ose gjithashtu NATO ka udhëhequr misionin në Libi për të zbatuar një zonë ndalim-fluturimi dhe mbrojtjen e civilëve, ndërsa OAS ka ndërmjetësuar me sukses mosmarrëveshjet territoriale ndërmjet Guatemala dhe Belize, dhe Kosta Rika dhe Nikaragua. Lidhja Arabe gjithashtu luajti rol në krizën siriane, kur pezulloi Sirinë nga anëtarësimi i saj, si dhe inicioi dhe udhëhoqi një mision vëzhgimi në Siri. Në shtator të vitit 2013, pas provave të përdorimit të regjimit të armëve kimike, ajo miratoi një rezolutë që mbështeti veprimin ndërkombëtar


kundër qeverisë siriane. Menjëherë pas kësaj, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 2118, mbështetur një iniciativë ndërkombëtare për të bashkëpunuar me qeverinë siriane për të shkatërruar armët kimike të vendit. Në të njëjtën kohë, organizmat e tjera multilaterale forcojnë kapacitetet për menaxhimin e konflikteve, si për shembull në korrik 2008, Banka Botërore ka themeluar një fond shtetëror për të mbështetur projektet për ndërtimin e paqes në shtetet e dobëta të prekura nga konflikti. Madje në vitin 2012 ajo nëpërmjet Qendrës për Konflikt, Siguri dhe Zhvillim miratoi një qasje fleksibile në kohë dhe situatë specifike për situata të brishta dhe të prekura nga konflikti. Kurse nga ana e tij Fondi Monetar Ndërkombëtar ka zgjeruar rrjedhat e tij të financimit në ndihmë emergjente të asistencës për të mbuluar postconflict dhe “grante kredi” që mund të përdoren për reformat që kanë për qëllim parandalimin e konfliktit të ardhshëm, si dhe ka qenë gjithashtu i përfshirë në mënyrë aktive në ndërtimin e sistemeve financiare dhe fiskale në vendet postconflict, si në Afganistan, Kosovë dhe Bosnje. Madje për shkak se këto institucione financiare ndërkombëtare nuk janë parë haptazi si politike, shtetet në përgjithësi janë më të gatshëm për të pranuar monitorimin, trajnimet dhe asistencën. Për më tepër, partneritete të reja mes qeverive, sektorit privat dhe shoqërisë civile kanë krijuar norma të reja dhe praktika për parandalimin e konfliktit dhe stabilizimin. Iniciativa e Transparencës e Industrisë Nxjerrëse dhe Procesit Kimberley, për shembull, kanë për qëllim të kufizojnë qeveritë dhe kompanitë që shfrytëzojnë burimet që financojnë dhe acarojnë konfliktet e armatosura. Por nga ana tjetër një numër i donatorëve kryesorë si Shtetet

e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Kanada dhe Holandë, investojnë në aftësitë e tyre të menaxhimit të konfliktit, të tilla si sistemet e zgjeruara të paralajmërimit të hershëm, të personelit civil dhe ushtarak me shpejtësi të dislokueshme, fondeve të dedikuara shteteve të prirur për konflikt dhe të prekura nga konfliktet, dhe proceset e planifikimit ndërinstitucional që kanë për qëllim sigurimin e përpjekjeve “të qeverisë” në vendet e rrënuara nga konfliktit si Afganistan, Irak, Sudan. Bashkësia ndërkombëtare ende është në sfidë në luftën për të ndërtuar politika koherente dhe të koordinuara.

Parandalimi i konflikteve

Një nga prioritetet më të rëndësishme të politikës e bën sot është ideja që konfliktet mund të parandalohen apo





të zbutet para se të shkallëzohen jashtë kontrollit. Qëllimi është për të reduktuar ndikimin dhe pasojat e konfliktit të armatosur, duke identifikuar dhe më pas trajtimin e tyre para se të mund të shpërthejnë në përshkallëzim të plotë. Kjo ka një efekt të drejtpërdrejtë në eliminimin e shpenzimit lidhur me një konflikt të tillë. Konflikte të reja janë një kërcënim real në klimën e sotme. Tensionet rreth armëve nukleare në Iran, Pakistan dhe Koresë së Veriut dhe një konkurrencë në rritje për burimet natyrore janë çështje të mundshme shpërthyes.

Lidhur me suksesin në parandalimin e konflikteve, zhvillimin apo përshkallëzimin ka mendime të ndryshme. Por nga njëra anë nëse shohim rreth 50- 60 viteve të fundit konfliktet mes vendeve duket se kanë rënë ndjeshëm,

kryesisht si rezultat i marrëveshjeve kolektive të sigurisë, i bilancit të armëve bërthamore dhe rritjes së ndërvarësisë ekonomike. Për shembull në vitin 2012, Baza e të dhënave, raportonte vetëm një konflikt ndërshtetëror mes Sudanit dhe Sudanit të Jugut. Megjithatë, konfliktet brenda shteteve edhe ato që përfshijnë aktorët jo shtetërorë, janë rritur në mënyrë dramatike, dhe tani përbëjnë gati të gjitha konfliktet në intensitet të lartë. Në vitin 2012, Barometri i Konfliktit raportoi se mbi 80 për qind, 314 konflikte të 396 të vëzhguara, ishin përbrenda shteteve. Por në të njëjtën kohë nënvizohet nevoja për parandalimin e konflikteve në mënyrë më të fuqishme me rikthim të luftërave të mëparshme civile, të cilat përbëjnë rreth 80 për qind të të gjitha shpërthimeve të konfliktit dhe përsëritjen e dhunës brenda dhjetë

vjet në rreth 40 për qind të të gjitha shokërive postconflict. Bashkësia ndërkombëtare punëson një shumëllojshmëri të mjeteve për parandalimin e konflikteve që synojnë shkaqet strukturore të konfliktit, kryerje të paralajmërimeve të hershme dhe vlerësime të konflikteve në zhvillim, përtë nxitur masa të bashkëpunimi si ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. OKB për ofrimin e vlerësimit për paralajmërim të hershëm dhe ndërmjetësimin e mbështetjen ka Departamentin e Çështjeve Politike, i cili përpilon raporte analitike dhe shënime informuese paralajmëruese të krizave fillestare, si dhe Njësinë e saj të specializuar për Ndërmjetësim e Mbështetje (MSU), që lehtëson trajnimin e ndërmjetësuesve paqeruajtës, mbështet proceset specifike të ndërmjetësimit, dhe ofron një bankë të dhënash të përvojës paqe ruajtje. Këto misione ndryshojnë në aspektin e mandatit dhe kapaciteteve, por ata të gjithë synojnë për të "ofruar një platformë përpara për diplomaci parandaluese dhe aktivitete të tjera nëpër një varg disiplinash, për të ndihmuar në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit apo për të ndërtuar paqe të qëndrueshme në vendet e dala nga luftërat civile". Por edhe organizata rajonale si BE dhe OSBE, kanë zhvilluar sisteme në fillim paralajmëruese por dhe kanë përparuar edhe me përgjigje të strukturuar. Përshembull programi i BE-së për Parandalimin e Konflikteve të Dhunshme "Programit Gothenburg", u formua për të "parandaluar konfliktet e dhunshme, vuajtje njerëzore dhe zhvendosjen sociale dhe ekonomike", dhe punon në koordinimi me Forcën e Veprimit të Jashtëm Evropian. Kurse OSBE nga ana e saj për të rritur parandalimin e konflikteve të hershme, krijoi Zyrën e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare në vitin 1992, e cila ka një mision të dyfishtë, për të përmbajtur dhe deshkalëzuar tensionet e pakicave, ose "Duke pranuar se gjinia është injoruar shpesh në përpjekjet në parandalimin

e konflikteve", ajo gjithashtu merr barazinë gjinore në konsideratë, me qëllim për të rritur aftësinë e grave apo raportuar te Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm. Rritja, mbështetja bilaterale nga donatorët kryesorë për paralajmërim të hershëm dhe përpjekjet e ndërmjetësimit, përmes Agjencisë së SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar, si dhe iniciativat dhe përpjekjet parandaluese me objekt paqen nga ana e BE janë forcuar, por analiza e konfliktit është ende një çështje e ndjeshme. OKB dhe organizatat rajonale mbështeten me përfaqësuesit, të dërguarit dhe udhëheqës të profilit të lartë për të informuar dhe mbikëqyrur negociatat specifike të një kombi apo një çështje, ajo ka pasur sukses duke përdorur burimet e ndërmjetësimit, duke filluar që nga mosmarrëveshjet kufitare midis Nigerisë dhe Kamerunit, të konflikteve civile në Tashikistan në konflikt me intensitet të lartë në Timorin Lindor, apo misioni preventiv në Maqedoni 1995-1999, si dhe misioni mbi monitorimin dhe raportimin mbi gjendjen e sigurisë përgjatë kufijve me Shqipërinë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, që konsiderohet gjerësisht si një sukses që solli paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Ekipi i këtyre ekspertëve është vendosur më shumë se shtatëdhjetë herë në mbi tridhjetë vende dhe aktualisht nëpër botë po luan një rol të rëndësishëm në ndërmjetësim.

Parandalimi mizorive masive, forcimi i operacioneve paqeruajtëse


Përpjekjet ndërkombëtare për të ndaluar në masë mizoritë e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, duket se kanë marrë vull në dy dekadat e fundit, me gjithë pamunësitë për të qenë e mjaftueshme. Edhe pse traktatet ndërkombëtare, risitë ligjore dhe përparimit të drejtësisë tranzicionale kanë dhënë normat dhe mjetet për të trajtuar krimet masive, parimet politike të sovranitetit dhe mos ndërhyrjes në punët e brendëshme shpesh pengojnë veprimin në këtë fushë. Presidenti Obama por edhe presidenti Bush kanë folur për "kurrë më sehir" në kryerjen e mizorive megjithatë ato në fakt vazhdojnë jo vetëm në Siri por edhe në vende të tjera. Kurse në vazhden e Holokaustit, shtetet anëtare të OKB-së kanë negociuar Konventën e vitit 1948 për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimet të Gjenocidit (Konventa Gjenocidi), që përcakton zyrtarisht gjenocidin dhe krimet. Edhe pse 142 vende e kanë ratifikuar Konventën e Gjenocidit, bota ka dëshmuar raste të përsëritura të gjenocidit dhe mizori të tjera masive që përfshijnë vrasjen masive të kryera nga regjimi Khmer Rouge në Kamboxhia mes viteve 1975 dhe 1979, gjenocidi Ruandës i vitit 1994, masakra e djemve të paarmatosur myslimanë dhe burrave në Srebrenicë, Bosnjë-Hercegovinë korrik 1995, pastrimi etnik në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999, si dhe vrasjet masive lëvizje të ngadaltë dhe uria në Darfur në mes të 2003 dhe fundi i vitit 2009, apo rastet e kohëve të fundit për të cilat poartikulohet shpesh, e në çdo rast, bashkësia ndërkombëtare nuk ka arritur të bashkohet në një përgjigje kolektive.

Në kushtet e rritjes së kërcënimeve trans nacionale dhe agjendat konkurruese, kërkesa globale për ruajtjen e paqes tejkalon vullnetin dhe kapacitetin për të ofruar mbështetje monetare apo operative për operacionet e paqes globale. "Paqeruajtës Multilateral", ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme që nga origjina në epokën e hershme të pas Luftës së Dytë Botërore. Paqeruajtës është konceptuar

kryesisht si një mënyrë për të mbajtur paqen midis shteteve duke futur vëzhgues ose forca ushtatake të armatosur lehtë, për ruajtjen e armëpushimit mes palëve kundërshtare. Me kalimin e kohës, si fusha e operacioneve të paqes dhe aktorët përkatës të përfshirë janë zgjeruar në mënyrë dramatike. Shumica e operacioneve të paqes sot ndodhin në kontekstin e konflikteve përbrenda shteteve, duke përfshirë edhe ato që mund të jenë ende në vazhdim, për të ndihmuar vendet e rënuar nga konflikti që të krijojnë kushtet e nevojshme për një paqe të qëndrueshme. Këto përpjekje shumëdimensionale janë humanitare, ushtarake, politike, dhe aktorët e zhvillimit të cilët punojnë drejt qëllimeve të ndërthurura të promovimit të sigurisë, avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, dhe duke hapur rrugën zhvillimit ekonomik. Për shembull gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, OKB është angazhuar në përpjekjet paqeruajtëse në mes të luftërave civile ose si pasojë e tyre, gjenocid, krimet masive, terrorizmit dhe rebelimeve radikale islamiste. Dhjetë vjet më parë, njëzet e shtatë mijë paqeruajtësit e OKB-së u vendosën në pesëmbëdhjetë operacione, kurse sot ajo mbikëqyr në mëse gjashtëmbëdhjetë operacionet dhe me mbi 118 mijë paqeruajtës në të gjithë botën. Gjithnjë e më shumë, organizatat rajonale gjithashtu veprojnë në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara për të formuar operacionet paqeruajtëse hibride, të tilla si misioni i përbashkët me BA në rajonin e Darfurit të Sudanit. Në mënyrë të ngjashme, në vitet e fundit ishin misionet e para tërësisht ushtarake, politika e mbrojtjes evropiane dhe e sigurisë në Maqedoni dhe Çad. Pavarësisht sukseseve të dukshme, OKB dhe operacione të tjera multilaterale dhe rajonale paqeruajtëse kanë pësuar disa dështime, si p.sh një dekadë pas Luftës së Ftohtë, zbulon defekte serioze në Somali, Bosnje dhe Ruanda. Në përgjigje të këtyre dështimeve, OKB-ja filloi një seri ristrukturimit dhe reforma, ku si rezultat i përpjekjeve, janë përmirësuar operacionet e paqeruajtjes, duke çuar në sukses në Timorin Lindor, Sierra Leone dhe Liberia. Por përveç problemeve lidhur mre përmirësimin e mëtejshëm dhe cilësisë në paqeruajtje opinionet nuk është se janë të një zëri dhe thuhet se ato janë "të përziera", lidhur me standardet e trajnimit të pabarabartë ndërmjet vendeve. Por edhe mungesa e standardeve të përbashkëta dhe të formimit profesional pengon përparimin madje në disa raste, dëmton reputacionin e paqeruajtës të OKB-së. Psh në vitin 2010, nga sipas raporteve doli se paqeruajtësit e OKB-së nga Nepali ishin burim i një shpërthimi vdekjeprurës të kolerës në Haiti, që vrau më shumë se shtatë mijë civilë në të gjithë vendin.

Qeveritë dhe organizmat ndërkombëtare kanë për qëllim për të parandaluar konfliktet e ardhëshme, duke shmangur pasojat të dëmshme njerëzore dhe financiare. Në veçanti Collier ka përshkruar "vdekje ushtarake dhe civile, sëmundje, shkatërrimin fizik, zhvendosje të popullsisë, shpenzimet lartë ushtarak, daljet e kapitalit, politikat dhe ndarje politike, trauma psikologjike dhe minave tokësore. Pjesa tjetër e botës vuan si rezultat, për shkak të daljeve të zbatimit të strehimit, ndihmës humanitare dhe operacioneve paqeruajtëse të shtrenjta". Prandaj në një politikë perspektiva dhe kostot e mundshme të konfliktit, e bëjnë veçanërisht tërheqëse idenë e parandalimit të konflikteve. Në terma financiarë shpenzimet për parandalimin e konfliktit janë më të mëdha se kostot dhe pasojat, kështu që vlera e monitorimeve të tilla lejon hartuesit e politikave për të miratuar dhe vënë në vend strategjitë e parandalimit të konfliktit.

The Four Types of Conflict



Problemi afgan dhe fushata kundër rebelimit (COIN) e forcave Aleate

Mësime të nxjerra nga misionet "Eagle" 1-7

Kolonel Dritan Demiraj
Shef i Qendrës së Simulimit

Problemi afgan

Forcat ushtarake të Aleancës, padyshim, janë të huaja në Afganistan. Kuptohet plotësisht se "problemi afgan" është një problem i vjetër, jashtëzakonisht kompleks dhe shumë i vështirë për t'u përmbledhur në këto pak rreshta. Sidoqoftë, problemi thelbësor afgan pas vitit 2006 ishte mjaft i qartë. Me gjithë përpjekjet maksimale të Aleancës gjatë fushatës konvencionale kundër rebelimit (COIN), rebelimi taleban po ashtu dhe Al-Qaeda mbetet një kërcënim i madh. Situata në Afganistan mbetet e paqëndrueshme dhe rrjeti i talebanëve dhe i Al-Qaeda-s ruan lirinë e lëvizjes në shumë zona "të kontestuara". Përgjatë këtij kapitulli, do të përpiqem që të shqyrtoj këtë problem kaq rëndësishëm në sa më shumë detaje që të jetë e mundur. Ky kapitull gjithashtu identifikon katër çështje kyçe të cilat unë gjykoj se kanë mundësuar këtë mungesë stabiliteti dhe dhune. Këto janë "konvencionaliteti" i forcave ushtarake të ISAF-it dhe të SHBA-së si dhe strategjia e luftës në Afganistan, Ushtria Kombëtare Afgane (ANA) krejtësisht jo efektive, Policia Kombëtare Afgane (ANP), e pa pajisur dhe e trajtuar shumë dobët, analiza mbi kryekomandantët dhe milicia afgane.

Shtimi i dhunës dhe i paqëndrueshmërisë nga ana e talebanëve dhe Al-Qaeda

Me gjithë rreth 60.000 trupat konvencionale të ushtrisë së SHBA-së, NATO-s dhe përafërsisht 85.000 trupave afgane "të trajnuara" dhe 90.000 trupave të policisë në terren, burime të shumta konfirmojnë se vitet 2005-2012 ishin vitet më të dhunshme që nga viti 2001. Për analizë studimi do të përpiqem të analizoj vitin 2005. Numri i amerikanëve të vrarë në luftime (KIA), gjatë vitit 2005, ishte në total 99 ushtarë (shih tabelën 2.1: Përmbledhja e Viktimave të Ushtrisë së SHBA në Operacionin për Lirinë e Qëndrueshme). Ky numër është më i lartë se çdonjëri nga katër vitet e mëparshme të luftës në Afganistan. Raportet nga terreni vënë në dukje se rritja e këtij numri ka ndodhur për shkak të shtimit të përdorimit të pajisjeve shpërthyes të improvizuara (IED) dhe makinave bombë kamikaze (VBIED) pranë bazave të mëdha amerikane ose rrugëve kryesore të furnizimit (MSR-s) nga ana e talebanëve dhe e grupeve të tjera terroriste që operojnë në Afganistan, sulmeve indirekte dhe shtimit të sulmeve direkte mbi bazat e përparuara operacionale, autokolonave dhe pritave të ndryshme. Pas kësaj, pak trupa amerikane, përveç disa forcave speciale (FS) dhe disa njësi të Çështjeve Civile (CA) operojnë rregullisht në zonat rurale të Afganistanit, krahas operacioneve që ndërmerren nga forcat konvencionale

Viti	Të plagosur	Të rënë
2001	35	12
2002	72	48
2003	96	48
2004	214	52
2005*	240	99

*deri më 1 janar 2006

Tabela 2.1. Përmbledhja e Viktimave të Ushtrisë së ShBA-së në Operacionet për Lirinë e Qëndrueshme.

të llojit "pastro dhe largohu".

Raportet e përditshme nga Afganistani na japin mundësi të kuptojmë trendin e rritjes së dhunës. Qeveria afgane (GOA) nuk ka kontroll të qendrave të saj më të mëdha të populluara dhe thuhet asnjë prani legjitime apo kontroll në fshatrat dhe qytetet afgane që njihen si "zona të pashkelura". Mungesën e kontrollit të qeverisë afgane mbi popullatën e saj, jam përpjekur ta ilustruj duke marrë informacion nga raportimet për rastet e incidenteve me dhunës, të cilat kanë ndodhur në Afganistan gjatë javës së fundit të marsit dhe javës së parë të prillit të vitit 2006:

- 03/29/06 Dy anëtarë të shërbimit të sigurisë, të vrarë gjatë luftimeve në Provincën Helmand

Një anëtar i Shërbimit të SHBA dhe një anëtar i shërbimit të Koalicionit u vranë në aksion-gjatë një sulmi armik mbi një bazë operacionesh të avancuara në Provincën Helmand;

- 03/30/06 Vritet Komandanti i policisë afgane, shefi rajonal dhe ushtarë të tjerë

Shefi i rajonit Dawlat Shah, Qadwr Khan dhe tre anëtarë nga stafi i tij u vranë nga militantët talebanë nga sulmet me raketa dhe me armë automatike kundër makinës së tyre, ndërkohë që Khan udhëtonte për në shtëpi;

- 03/30/06 Një Bombë e telekomanduar vret tre afganë në Provincën Khost

Në provincën juglindore të Khostit, dy civilë dhe një polic u plagosën në rajonin Ali-Khil të provincës, pas një shpërthimi të telekomanduar ndaj autokolonës së policisë afgane;

- 03/30/06 Vritet Shefi i policisë dhe i vëllai në provincën Helmand

Militantët talebanë sulmuan dhe vranë një shef policie dhe vëllanë e tij në Provincën Helmand.

- 03/31/06 Ushtarët rumunë të plagosur në Afganistan

Dy ushtarë nga Batalioni i 341-të të Këmbësorisë "Peshkaqenët e Bardhë" morën plagë të lehta gjatë misionit të tyre, rreth 30 km në juglindje nga baza e Kandaharit, Afganistan;

- 03/31/06 Shpërthimi trondit bazën kanadeze

Shpërthimet u shkaktuan nga tre predha 107 mm, të cilat ranë brenda gardhit të sigurisë së aerodromit të Kandaharit;

- 04/01/06 Pesë trupa amerikane të plagosura nga një shpërthim në Afganistan

Pesë ushtarë amerikanë u plagosën nga një shpërthim në anën e rrugës, në luginën Peche të provincës së Kunarit

lindor, pranë kufirit me Pakistanin;

- 04/01/06 Shkëmbimi i zjarrit në jug të Afganistanit të 6 talebanë të vdekur, fshatrat ku vepronin ata rimerrren nga forcat e koalicionit përsëri

Gjashtë militantë talebanë janë vrarë gjatë një përplasje me trupat e ISAF-it dhe ato qeveritare, të premtën, në rajonin Kajaki të Provincës Helmand, duke bërë që trupat qeveritare t'i zmbropsin militantët nga fshatrat;

- 04/02/06 5 policë afganë të vrarë, kamionët amerikanë të furnizimit digjen në Afganistan

Pesë policë afganë u vranë dhe katër kamionëve që mbartin furnizime për në bazën amerikane iu vu zjarri në Provincën Helmand, në jug të Afganistanit.

Në vijim të dhunës tipike të paraqitur sa më sipër, duke marrë si shembull vitin 2006, rebelët talebanë dhe Al-Qaeda në Afganistan kanë shtuar përdorimin e sulmeve kamikaze. Rebelimet në Afganistan duket se po imitojnë suksesin e sulmeve kamikaze, të përdorura kundër forcave të Koalicionit në Irak. Për shembull, në vitin 2004, rebelët afganë kryen pesë sulme kamikaze me bomba dhe e shtuan ato në 17 sulme kamikaze gjatë vitit 2005. Kjo prirej alarmante vazhdoi ndërkohë që talebanët dhe Al-Qaeda ndërmorën 13 sulme kamikaze me bombë në dhjetë javët e para të vitit 2006. Rebelët në Afganistan duket se e kanë kuptuar qartë efektivitetin e bombave kamikaze në Irak: popullata është e destabilizuar, trupat qeveritare janë irrituar dhe shpesh civilët e pafajshëm sulmohen si të dyshuar për bomba kamikaze duke bërë që qeverisja të humbasë legjitimitetin. Ndikimi i përgjithshëm në Irak ishte dëmtimi i disa partnerëve kyç të Koalicionit të cilët pas humbjeve të mëdha në njerëz dhe mjete, janë tërhequr nga Iraku, si rezultat i përdorimit të këtyre metodave dhe i këtij destabiliteti. Padyshim që rebelët afganë po shpresojnë të arrijnë të njëjtat rezultate dhe në Afganistan. Presidenti i Afganistanit, Hamid Karzai, tha se Newsweek ka ndjekur me vëmendje trazirat në muajin maj dhe për pasojë, reagimi i vrazhdë i ushtrisë dhe policisë afgane "tregon se institucionet e Afganistanit, policia, ushtria, nuk janë ende të gatshme që t'i bëjnë ballë protestave dhe demonstratave." Edhe lideri më i lartë i Afganistanit e pranon se qeverisë së Afganistanit i mungon kontrolli mbi popullatën e saj. Sigurisht, duket se jeta e përditshme në Afganistan mbetet tejet e pasigurt dhe ndikimi mbi Afganistanin rural kontestohet shumë nga një rebelim i vazhdueshëm dhe në rritje i talebanëve dhe Al-Qaeda. "Konvencionaliteti"

i forcave kundër rebelimit të SHBA dhe Aleancës në Afganistan dhe strategjia e tyre jo efektive, është një tjetër faktor kyç për t'u marrë parasysh për rikthimin e kërcënimit të talebanëve dhe Al-Qaeda.

"Konvencionaliteti" i Forcave të SHBA-së/Aleancës dhe strategjia e tyre

Pavarësia operacionale e grupeve speciale të FS në vjeshtën e 2001, megjithëse tepër efektive, pati jetë të shkurtër. Energjike për t'u përfshirë në të vetmen luftë që u bë e njohur në arenën ndërkombëtare me termin GWOT (Global War on Terror), menjëherë pas tyre, Forcat Konvencionale të SHBA filluan zbatimin në Afganistan në fundin e dimrit të vitit 2001. 18.000 trupat konvencionale të SHBA-së që përfundimisht do të dislokoheshin në Afganistan, do të tejkalonin shumë angazhimin fillestar, të disa qindra operatorë amerikanë të FS dhe agjencive sekrete të cilët mundësuan rrëzimin e regjimit të talebanëve (shih Tabelën 2.2: "Konvencionaliteti" i Forcave Amerikane në Afganistan). Rasti në Afganistan ilustron qartë se thjesht shtimi në numër i trupave konvencionale amerikane në luftimet COIN, nuk e garanton fitoren.

Data	Dhjetor 2001	Nëntor 2005
Komanda Amerikane	TF-Dager	CJTF-76
Përbërja	Elementë të 1/5 th SFG (grupi % i FS), 2/5 th SFG, 3/5 th SFG, HQ 5 th SFG, të tjera SOF, FS aleate dhe njësitë e CIA (shërbimeve sekrete) (Interview with Special Forces officers, Ft.Bragg, NC, 25 shtator 2005)	82 nd ABN (parashutiste), 173 rd ABN, 158 th AVN, B/2/6 th , CAV(Delta Force), F/159 th AVN (aviacion), 65 th MI (zbulim ushtarak), 391 ^{te} EN (xhenio), 864 th EN, 141 th IN, 249 th MED (mjekësi), A/44 SIG (ndërlidhje), 155 SIG, 580 SIG, 749 th ORD, 789 th EOD, 11 th ASOG, 92 ^{te} MP, 298 th EN, 74 th LRSD (logjistikë dhe mbështetje luftimi), CJSOTF-A, njësi të tjera të Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara, Marinat dhe Flota.
Forca	Më pak se 500 trupa SOF	Afërsisht 18.000 ushtarë

"Konvencionaliteti" i Forcave Amerikane në Afganistan

Faktorët kyç të cilët kanë kontribuar në "konvencionalitetin" e fushatës së Afganistanit. Janë: Krijimi i Task Forcës së Përbashkët Konvencionale (CJTF); mbizotërimi i operacioneve konvencionale "pastro dhe largohu" dhe reduktimi i FS.

Së pari, krijimi i një komande konvencionale në Afganistan, e quajtur CJTF-76, sipas gjykimit tim është bërë joproduktive në një luftë, të cilën e pranojmë se është "jokonvencionale" për nga natyra. CJTF

komandohet nga një gjeneral i forcave konvencionale me tre yje. Oficeri atë vit me gradën më të lartë të FS në Afganistan, kolonel, nuk kishte as "një vend në tavolinë" gjatë shumë mbledhjeve dhe vendimeve të rëndësishme. Është jo produktive që një komandë konvencionale e ushtrisë, është e ngarkuar të drejtojë atë që është qartësisht një luftë jokonvencionale.

Së dyti, mbizotërimi i mentalitetit të një ushtrie konvencionale demonstron në kryerjen e operacioneve "pastro dhe largohu" në shkallë të gjerë për të përzënë armikun. Operacioni Anaconda (në mars të vitit 2002, i shpjeguar në kapitullin III), operacioni Mountain Viper (gusht 2003), operacioni Avalanche (dhjetor 2003), operacioni Mountain Storm (korrik 2004) dhe operacioni Lightning Freedom (dhjetor 2004), operacioni Mountain Viper (dhjetor 2010) janë të gjithë shembuj themelorë të "operacioneve "pastro dhe largo" tërësisht jo efektive. Këto lloj operacionesh nuk funksionuan as në Vietnam dhe nuk janë duke funksionuar as tani në Afganistan. Një komandant i forcave konvencionale të këmbësorisë në Afganistan pranon se operacionet e tilla kryhen vetëm për "të nxjerrë jashtë rrethimit trupat e veta." Përfundimisht, FS, të cilat janë ekspertët e ushtrisë në luftën konvencionale (UW) dhe COIN, janë duke u lënë mënjanë në Afganistan. Potenciali i pafund i FS është zbehur nëpërmjet keqpërdorimit kronik të tyre nga ana e komandantëve të këmbësorisë. Besojmë se edhe vetë FS duhet të marrin përsipër pjesën e vet të fajit për këtë keqpërdorim, duke qenë se këto forca po mbahen larg operacioneve jokonvencionale dhe kundër-kryengritëse (COIN) në Afgani-

stan. Grupet e FS ndërprejnë operacionet në shkallë të gjerë "nëpërmjet dhe me" forcat vendase afgane dhe u zhvendosën në operacione më të vogla në kufirin e Pakistanit duke mbledhur të dhëna zbulimi dhe duke ndjekur terroristët duke realizuar goditje direkt (DA). Besojmë se kjo zhvendosje e fokusit ishte një gabim serioz dhe duhet që këto forca të rikthehen në rolin e tyre më tradicional të operimit me forcat afgane të sigurisë. (Po flasim gjithmonë për vitin 2005).

Përse Hamasi dëshiron luftë?

Siç ka vënë në dukje Geoffrey Blainey në studimin e tij mjeshteror "Shkaqet e luftës", politikanët i nisin luftërat kur janë optimistë për perspektivat që ato ofrojnë për të nxjerrë fitime; përndryshe do të përqipeshin t'i shmangnin. Përse atëherë Hamasi sapo provokoi një luftë me Izraelin? Papritur e pakujtuar, më 11 qershor nisi hedhjen e raketave, duke thyer qetësinë që zotëronte aty që prej nëntorit 2012. Misteri i "arsyeve" të këtij shpërthimi, e nxiti David Horovitz-in, redaktorin e "Times of Israel", të nxjerrë në dukje faktin që luftimet aktuale nuk kanë "as justifikimin më të vogël". Dhe përse udhëheqja e Izraelit u përgjigj në mënyrë minimale, në përpjekje për ta shmangur luftën? Dhe kjo në një kohë kur të dyja palët e dinë mirë që forcat e Izraelit ia kalojnë ndjeshëm atyre të Hamasit në çdo aspekt - mbledhje informacioni, komandë dhe kontroll, teknologji, fuqi goditëse dhe mbizotërim të hapësirës tokësore, ajrore dhe detare. Si shpjegohet atëherë ky ndryshim rolesh? Janë Islamistët vërtet kaq fanatikë sa të mos e vrasin mendjen që do të humbasin? Po Izraelitët, i preokupon vallë kaq shumë humbja e jetës në luftë? Në fakt, udhëheqësit e Hamasit janë mjaft "racionale". Në mënyrë periodike (2006, 2008, 2012), ata vendosin të hyjnë në luftë me Izraelin të qartë që në fushëbetjeën ushtarake do të humbasin, por optimistë për fitoren në planin politik. Ndërsa udhëheqësit izraelitë hamendësojnë që nga pikëpamja ushtarake do të dalin fitimtarë, por nga ana tjetër i tremben humbjes në planin politik - mbulim negativ ndërkombëtar dhe kritika nga shtypi botëror, rezoluta të OKB-së e kështu me radhë. Zhvendosja e fokusit në planin politik është diçka me rëndësi historike; gjatë 25 viteve të para të saj, ekzistenca e Izraelit u sfidua në mënyrë të përsëritur (veçanërisht në vitet 1948-49, 1967 dhe 1973) dhe askush nuk e dinte se si do të përfundonin ato luftëra. Le të kujtomë ditën e parë të luftës Gjashtë Ditore të vitit 1967, kur egjiptianët trumbetonin fitore të shkëlqyera ndërkohë që heshtja e plotë nga ana e shtypit të Izraelit të linte të nënkuptoje një katastrofë. Lajmi që Izraeli kishte shënuar fitoren më të madhe në analet e luftërave, që vërtet shokues. Ajo çfarë ka rëndësi të theksohet është që mënyra se si do të përfundonte lufta u përcaktua në mënyrë krejt të paparashikueshme në sheshbetje. Por nuk është më kështu: Rezultati i luftërave arabo-izraelite në 40 vitet e fundit ka qenë mëse i parashikueshëm; çdokush e di që forcat izraelite do t'ia dalin mbanë. Por më shumë se çështje lufte, ajo është kthyer në njëfarësoj si në një lojë polici-hajduti. Në mënyrë paradoksale kjo lloj asimetrie e largon vëmendjen nga fitorja dhe humbja dhe e kthen atë nga moraliteti dhe politika. Armiqtë e Izraelit e provokojnë atë që të vrasë civilë, vdekja e të cilëve u sjell përfitimë të shumëfishta. Katër konfliktet e shpërthyer që prej vitit 2006 ia kanë riptëritë Hamas-it famën e zbehur si "lëvizje për rezistencë," kanë krijuar solidaritet në frontin e brendshëm, kanë ngjallur mosmarrëveshje mes arabëve dhe hebrenjve në Izrael, i kanë dhënë zemër palestinezëve dhe



myslimanëve të tjerë të hedhin veten në erë, kanë vënë në siklet udhëheqësit arabë jo-islamistë, kanë garantuar rezoluta të reja të Kombeve të Bashkuara në dëm të Izraelit, kanë frymëzuar europianët të vendosin sanksione edhe më të ashpra kundër Izraelit, kanë hapur rubinetet e kritikave gërryese të disa Ndërkombëtarëve kundër shtetit Hebre dhe kanë siguruar ndihma shtesë nga Republika Islamike e Iranit. Kauza e shenjtë e luftës politike është të fitojnë

sa me shumë simpati mbarëbotërore duke e paraqitur veten si humbës dhe viktima (Ia vlen të përmendet nga pikëpamja historike kjo, sepse është shumë e çuditshme: Tradicionalisht, luftëtarët e Hamas-it apo edhe Palestinezët në përgjithësi, përqipen ta trembin armikun duke u paraqitur si të frikshëm dhe të pandalshëm). Pjesë e taktikave të kësaj lufte të re është dhe paraqitja e një momenti emocionale bindëse, përmendja e mbështetjes nga

personalitete të famshme, thirrjet drejtuar ndërgjegjes, vizatimi i karikaturave politike të thjeshta, por të fuqishme (mbështetësit e Izraelit kanë shkëlqyer në këto të fundit, si në të kaluarën dhe tani). Palestinezët janë treguar edhe më krijues duke krijuar teknika binjake mashtrimi: "Fauxtography"-në për dizinformimin nëpërmjet fotove të rreme si dhe "Pallywood"-in për video. Në të kaluarën, izraelitët kanë treguar një lloj vetëkënaqësie lidhur me nevojën për

atë çfarë ata quajnë "hasbara", dhënien e mesazhit jashtë vendit, (nevojën për të bërë propagandë), por vitet e fundit i kanë kushtuar kësaj "hasbara"-je më shumë vëmendje. Majat e kodrave, qytetet dhe rrugëkalimet strategjike kanë rëndësi të jashtëzakonshme në luftërat civile në Siri dhe Iran, kurse moraliteti, proporcionaliteti dhe drejtësia janë ajo çfarë mbizotëron në luftërat arabo-izraelite. Siç është shkruar shumë gjatë kohës së përbaljes mes Izraelit dhe Hamasit në vitin 2006, "Solidariteti, morali, besnikëria dhe mirëkuptimi kanë zënë vendin e çelikut, gomës, naftës dhe municioneve." Apo në vitin 2012: "Editorialet i kanë zënë vendin plumbave, media sociale u kanë zënë vendin tanksave." E thënë më në përgjithësi, kjo është pjesë e një ndryshimi themelor në luftërat e kohës sonë kur përleshjen forcat perëndimore dhe ato jo-perëndimore, si në luftërat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara në Afganistan dhe Irak. Siç do të thoshte strategu prusian Clausewitz, opinioni publik është qendra e re e gravitetit. Pas gjithë kësaj që u përshkrua me lartë, si i ka punët Hamasi? Jo mirë. Humbjet në fushëbetje që prej 8 korrikut duken dhe më të larta se sa pritshin dhe dënimet mbarëbotërore kundër Izraelit nuk kanë vërshuar ende. Madje dhe media arabe relativisht nuk janë ndjerë. Nëse kjo vazhdon, Hamasi mbase arrin në përfundim që breshëritë e raketave kundër shtepive izraelite nuk janë ide fort e mirë. Dhe vërtet, për ta bërë të ndërrojë mendje e të mos ndërmarrë ndonjë sulm të ri për disa vjet, duhet që "Hamasi" t'i humbasë të dyja luftërat si në planin politik dhe në atë ushtarak, dhe t'i humbasë shumë rëndë.

Marrë nga: "National Review"
Përgatiti: Arben Idrizi

A bëhet Rusia më e pavarur nëse Perëndimi rrit sanksionet ndaj saj?

Ministri i jashtëm Rus, Sergej Lavrov, ditën e hënë në një konferencë për media, në lidhje me sanksionet e BE dhe SHBA kundër Ruisë, deklaroi: sanksionet nuk realizojnë objektivat e pritura dhe ne do të tejkalojnë çdo problem dhe çdo sfidë në fushën e ekonomisë, ndërsa mund të ndodhë që sanksionet të bëhen shkak që ne të jemi më të pavarur dhe të mbështetemi plotësisht në forcën tonë. Moska do t'i përgjigjet sanksioneve të perëndimit, por përgjigja e Moskës do të jetë logjike dhe në mënyrë të ndryshme, - shtoi ndër të tjera Lavrov. Tensionet e marrëdhënieve të Ruisë dhe Perëndimit pas rritjes së krizës në Ukrainë, janë shtuar vazhdimisht. Vetë BE të premtën e kaluar arriti në një marrëveshje të përgjithshme për vendosjen e sanksioneve të para ekonomike kundër Ruisë, por ka kufizuar përmasat e këtyre sanksioneve në mënyrë që këto sanksione mos të përfshinin edhe teknologjinë për prodhimin e gazit. Perëndimi pa asnjë dallim në listën e sanksioneve ka vendosur edhe emrat e 15 personaliteteve dhe funksionarëve shtetëror të Ruisë ose Ukrainës ku në mesin e tyre vërehet edhe Aleksandër Bartnikov, kryetar i



shërbimit të sigurisë federale të Ruisë, dhe Mikhail Fradkov, kryetar i shërbimit të jashtëm inteligjent të Ruisë. Në listën e sanksioneve të BE dhe SHBA kundër Ruisë janë përfshirë edhe 18 kompani dhe organizata të cilat akuzohet se po ndihmojnë grupet kryengritëse në Ukrainë. Në bazë të këtyre sanksioneve, këtyre personave dhe organizatave do t'i bllokohen të gjitha pasuritë e depozituara në BE dhe në SHBA si dhe do t'i ndalohet udhëtimi i tyre në këto vende. Ministria e Punëve të Jashtme të Ruisë ka paralajmëruar Evropën se nuk ka perceptim të drejtë ndaj sfidave të gjera të sigurisë politike dhe

ekonomik, që krijohen për shkak të shtimit të sanksioneve kundër Ruisë. Gjithashtu zyrtarë të lartë nga po kjo Ministri kanë deklaruar: se shtimi i sanksioneve të BE dhe SHBA kundër Ruisë do të ketë ndikim negativ mbi bashkëpunimet bilaterale për luftën kundër zgjerimit të armëve të shkatërrimit në masë, për luftën kundër terrorizmit si dhe mbi bashkëpunimet e tjera të fushës së sigurisë. Funksionarët perëndimorë pretenduan se sanksionet janë vendosur për shkak të ndërhyrjes së Ruisë në punët e brendshme të Ukrainës. Kjo është në kohën kur autoritetet e Ruisë vlerësojnë se shkak kryesor i tensioneve

në Ukrainë është ndërhyrja e SHBA dhe e BE në këtë vend. Natyrisht se në këtë mes, disa shtete perëndimore besojnë se sanksionet ekonomik kundër Ruisë do të kenë ndikim negativ mbi ekonominë e shteteve perëndimore, dhe kjo nuk është aspak për tu nënvlehtësuar si sot dhe në perspektivën e afërt apo të largët të ekonomive të këtyre vendeve. Deivid Kamerun, kryeministër i Britanisë së Madhe, më herët ka thënë se padyshim që vendosja e më shumë sanksioneve kundër Ruisë do të ketë ndikim negativ edhe mbi shtetet evropiane, për arsye se të dyja palët kanë shkëmbime të gjera tregtare, sepse shtetet evropiane janë të varura nga resurset energjetike të Ruisë. Edhe William Murai, zëdhënës i FMN, gjithashtu kohëve të fundit ka paralajmëruar rreth pasojave të sanksioneve të perëndimit kundër Ruisë. Ai deklaroi: sanksionet e shteteve perëndimore kundër Ruisë, padyshim që pikësepari do të ndikojnë negativisht mbi shtetet e tjera të rajonit të cilat kanë marrëdhënie tregtare shumë aktive me Moskën, sidomos shtetet e Azisë Qendrore dhe Evropës Lindore dhe Qendrore.

Marrë me shkurtime nga: WSJ
Përgatiti: Arben Idrizi

VLORË-GJIROKASTËR-MALLAKASTËR 1943-1944

Vlerat dhe rëndësia e "Zonës së Parë Operative"

Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ
Historian ushtarak

Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër (Z1Op) u krijua më 4 gusht 1943, në Kuç të Kurvelshit. Z1Op ishte një tip formacioni me paraqitje të veçantë, me karakteristika dalluese nga ato të formacioneve të mëparshme apo ato pasuese, si Br.S etj. Si tip formacioni ajo mbeti e vetmja në llojin e vet në shkallë vendi dhe nuk u pasua nga të tjerë. Në pikëpamjen ushtarake përbënte një formacion të shkallës operative me mundësi të mëdha luftarake, por edhe administrative dhe me rezerva të pashtershme njerëzore, morale e materiale në shërbim të luftës dhe të misionit të saj çlirimtar. Z1Op u shtri në qarqet e Vlorës dhe të Gjirokastrës, si dhe në krahinën e Mallakastrës dhe pati disa karakteristika të veçanta si: një sipërfaqe mjaft të gjerë, me dalje në det dhe kufi me Greqinë prej disa km; terren tepër të përshtatshëm për mbrojtje, për sulm dhe për prita; shtrihej në mjaft zona e krahina të çliuara, me tradita atdhetare të ndezura duke u kthyer në baza të fuqishme të LANÇ-it, në prag të krijimit e gjatë funksionimit të shtabit të Zonës; popullsia në shumicën dërmuese ishte e lidhur me luftëtarët e lirisë dhe kishte traditë luftarake; u bë një burim i pashtershëm e i përhershëm për furnizimin e formacioneve partizane me luftëtarë, me ushqime e veshmbathje, duke krijuar kushte edhe për formimin e formacioneve më të mëdha të ushtrisë së rregullt, krahas plotësimit të nevojave të formacioneve të veta luftarake partizane e vullnetare; rol luajtën edhe besimet fetare, veçanërisht ajo bektashiane, që ishte më e përhapur në zonë. Lidhjet, vartësitë e raportet që u mbajtën ndërmjet formacioneve të ndryshme luftarake e ndihmëse të Z1Op, janë të ndryshme nga ato të njëjstëve apo të formacioneve të tjera. Qarqet ushtarake këtu u vunë plotësisht në vartësi të Komandës e të Shtabit të Z1Op, ndërkohë që qarqet e tjera vareshin drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm (SHP). Në juridiksionin e Z1Op kishte forca që vareshin drejtpërdrejt prej saj e më pas u krijuan dhe vepruan në gjithë hapësirën e Zonës edhe njësi sulmuese të shkallës operative (Br.S), të cilat vareshin nga SHP, por që sipas detyrave të këtij të fundit, bashkëvepronin dhe kryenin detyra me ide dhe objektiva të përbashkëta me Z1Op. Në Zonë u realizua një gërshtim i përkryer i veprimeve luftarake të formacioneve të vet Zonës (Gr.P, b.p. dhe formacioneve vullnetare partizane, si dhe të gjithë komandave të qarqeve dhe të vendit, spitaleve partizane, depove, punëtorive, e deri te skuadrat e mirëmbajtjeve të rrugëve, ndërlihdja etj), por edhe në mes tyre dhe Br.S partizane që vepronin në Zonë. Z1Op, në vartësi nga koha dhe rrethanat, organizoi dhe



kreu veprime luftarake fillimisht me forcat e veta partizane e vullnetare, deri në nëntor 1943 dhe, më pas, edhe në bashkëveprim me njësitë sulmuese të SHP, deri më tetor 1944, kur pushoi veprimtarinë. Analiza e funksionimit të Komandës e Shtabit të Z1Op me gjithë

shkallët hierarkike të saj, si dhe e veprimtarisë së dëndur të saj, evidencon qartazi dy shtylla mbi të cilat ajo është mbështetur dhe ka realizuar detyrat që shtronte Këshilli i Përgjithshëm ANÇ, si dhe SHPUNÇSH, funksioni luftarak dhe administrativ i saj. Zona në funk-

sionin e saj luftarak ka qenë organizatore dhe pjesëmarrëse e drejtpërdrejt duke luajtur rol të rëndësishëm edhe në momentet më kyçe në veprimtarinë luftarake të vet UNÇSH. Kështu mund të theksojmë: veprimet e njëkohshme për përballimin e sulmit gjerman dhe

çarmatosjen e forcave italiane pas kapitullimit të këtij të fundit; realizimin me sukses për kushtet e kohës e luftës së parë ballore në Drashovicë, në Konispol me 1943 etj; përballimin e gjendjes dhe zhvillimeve komplekse luftarake të krijuar gjatë dy mësymjeve të mëdha e të përgjithshme gjermane gjatë Dimrit 1943-1944 dhe të Qershorit 1944 krahas disa operacioneve të pjesshme të forcave gjermane dhe të bashkëpunëtorëve të tyre; pjesëmarrjen aktive në Kundërmësymjen Pranverore të UNÇSH (prill-maj 1944); çlirimin e plotë të qyteteve dhe të territorit të vet Zonës në bashkëpunim me njësitë e UNÇSH, apo dhe vetëm dhe mbrojtjen e punimeve të Kongresit të Përmetit. Komanda dhe shtabi i Z1Op në funksionin e vet administrativ, ka kryer një kompleks detyrash, më kryesoret janë: ngritja, forcimi dhe mbrojtja e pushtetit të popullit në luftën që realizohej nëpërmjet Këshillave NÇ të fshatrave, krahinave, qyteteve e qarqeve; puna politike, sqaruese dhe mobilizuese me popullin, mbrojtje e popullsisë nga operacionet dhe veprimet luftarake të armikut dhe veglave të tij, si dhe ndihma për kapërcimin e vështirësive të operacioneve të armikut, në veçanti dhe të gjendjes së luftës në tërësi; dhënia e ndihmës për familjet më me

DREJTUES

Komandant, kapiten Islam Radovicka

Lindur më 22 shkurt 1889, në fshatin Radovickë të Përmetit. Kreu shkollën qytetëse, gjimnazin dhe përfundoi Shkollën Ushtarake në Tiranë. Si oficer karriere dhe me dëshirën e mirë për të ecur përpara, shërbeu në disa reparte dhe struktura të ndryshme të ushtrisë, si në degët ushtarake dhe të organizimit të paraushtarakëve, nëndrejtor në Shkollën e Rekrutimit në Shkodër, komandanti i Autorepartit të Ushtrisë dhe punoi në specialitetin e rekrutimit në degët e zonave të Kolonjës, Mirditës, Shkodrës, Sarandës etj. Në shkurt 1943 ai braktisi ushtrinë dhe u lidh me LANÇ-in. Mori pjesë në të gjitha veprimet luftarake që organizoheshin dhe zhvilloheshin në zonën e Përmetit. Për aftësitë e tij të veçanta, si ushtarak karriere, i përgatitur, atdhetar dhe me reputacion në këtë zonë iu besua udhëheqja dhe drejtimi i këtij shtabi të veçantë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në ecurinë e luftës, me rritjen e UNÇSH, figura e tij erdhi duke u rritur, në saj të aftësive të tij drejtuese, organizuese e luftarake në fushën e luftimeve të formacioneve partizane që komandonte. Në luftimet dhe operacionet që u kryen në këtë zonë, u ndie dora dhe mendimi i tij si ushtarak me funksione të larta dhe i kalitur në provat e luftës. Në të gjitha dokumentet, urdhrat, komunikatat dhe udhëzimet e këtij shtabi është ndier mendimi profesional dhe aftësia e tij prej komandanti dhe udhëheqësi ushtarak.



DREJTUES

Komisar politik, toger Bedri Spahiu

Lindi në qytetin e Gjirokastrës më 13 korrik 1908. Kreu në Stamboll shkollën italiane. Përfundon Shkollën Ushtarake në Tiranë në degën e artilerisë më 1931 dhe u titullua oficer. Radhitet që në fillim në lëvizjen komuniste në qytetin e Gjirokastrës. Me potencialin e tij intelektual, me aftësitë e tij ushtarake dhe komunikuese e organizuese, bëhet një nga organizatorët e kryengritjes së armatosur që në fillimet e saj. U zgjodh sekretar politik i partisë për Gjirokastrën. Me dinamizmin dhe oratorinë e tij fiton popullaritet dhe luan një rol të veçantë në gjallërimin e lëvizjes në Shqipërinë e Jugut. Në korrik 1943, zgjidhet anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, si dhe caktohet komisar i Z1Op. Duke qenë në krye të operacioneve të fuqishme, që u zhvilluan në këtë zonë, dha një kontribut të madh për rritjen e lëvizjes ushtarake dhe formimin e disa njëstëve. Në kushtet e një lufte popullore, në këtë detyrë shfaqti aftësi të spikatura të një ushtaraku me kulturë, me ndikimin edhe në përgatitjen e të gjitha materialeve luftarake, duke merituar me të drejtë nderim dhe respekt nga partizanët dhe populli i kësaj krahine. Në të gjithë veprimtarinë politike të zonës fjala e tij, nëpërmjet përpilimit, veçanërisht të gjithë dokumentacionit propagandistik të kohës, pati një rëndësi të madhe për frymëzimin dhe ngritjen në luftë të masave popullore. Epërsia e tij intelektuale, njohës i çështjeve ushtarake dhe ndihmës në hartimin e urdhrave, udhëzimeve dhe instruksioneve, që dilnin nga Shtabi i Z1Op. Ishte njohës i mirë i gjuhëve frëngjisht dhe italisht. Më pas shkoi përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm pranë misionit ushtarak anglez në Bari të Italisë.





nevojë e veçanërisht të atyre partizane, të dëshmorëve etj; mobilizimi dhe furnizimi i formacioneve luftarake me luftëtarë e materiale në çdo kohë e situatë; sigurimi i të dhënave informative, prapuni i tyre dhe marrja e masave për përballimin e operacioneve të vazhdueshme; organizimi e riorganizimi i vazhdueshëm i formacioneve partizane, të Zonës, të pushtetit ushtarak të prapavijave duke bërë furnizime me forca njerëzore e materiale; sigurimi i funksionimit të pushtetit të prapavijave në zonat e çliruara dhe vendosja në to e spitaleve, depove, punëtorive etj; në vartësi nga mundësitë ringritja e funksionimit e sistemit arsimor veçanërisht atij fillor e 7 vjeçar; rindërtimi e mirëmbajtja e rrugëve, i linjave telefonike etj; likuidimi i agjenturës zerviste, demaskimi i bashkëpunësve të nazistëve dhe i veprimtarisë së tyre armiqësore etj. Krahinat e Z1Op kanë luajtur rol të rëndësishëm në plotësimin e detyrave luftarake e administrative nga të cilat vareshin. Sipas direktivave të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH dhe vendimeve të Komandës

së Zonës, më 10-11 tetor 1943, u krijuan 5 grupe partizane me nga tre batalione secili. Por pati dhe grupe si Grupi i Tretë i Mallakastrës që kishte katër batalione. Por komanda e shtabi i saj mbajtën në rezervë dhe dy batalione. Kështu Zona kishte gjithsej 18 batalione partizane të organizuar dhe gjithmonë në gatishmëri të përhershme luftarake. Z1Op, në fushën e organizimit ushtarak, për vetë masën e gjerë të kontingjenteve që zotëronte krahina e Labërisë dhe ajo e Mallakastrës, por dhe të mobilizimit të popullit në luftë, shërbeu si burim i pashtershëm furnizimi me kontingjent njerëzor të 7 brigadave partizane të hapura në të gjithë Zonën. Të tilla ishin Br. V, VI, VIII, XII, XIV, XIX dhe XI S, si dhe plotësimin me kontingjente të shumta të brigadave të tjera të UNÇSH-së, si Br. I, II, III, IV, XVI S etj. Mbi 16.000 djem e vajza u përfshinë në formacionet partizane dhe ranë në fushën e nderit 2130 dëshmorë. Në hapësirën e Z1Op vepronin edhe formacione luftarake të UNÇSH-së, si brigada sulmuese. Komanda e shtabi i Z1Op organizoi dhe ushtroi edhe pushtetin e prapavi-



jave të Zonës si dhe formacionet ndihmëse luftarake të UNÇSH-së, çetat e batalionet territoriale në gjithë hapësirën e saj gjeografike. Forcat e Z1Op, nën drejtimin e komandës dhe të shtabit të Zonës, kryen një sërë veprimesh luftarake të rëndësishme. Në shkallë zone u zhvilluan beteja të tilla si lufta e Konispolit, lufta e Libohovës, lufta e Drashovicës. Pas kapitullimit të Italisë fashiste (1943) forcat e Zonës çarmatosën posta e garnizone të divizioneve italiane "Parma" e "Peruxhia" në Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Sarandë, Drashovicë etj. Në bashkëpunim me brigadat sulmuese që gjendeshin në zonë, Komanda e shtabi i Zonës përballuan një sërë operacionesh të pjesshme nazistëve gjermanë, si atë "Eilbote", "Sturm", "Bergeseel", si dhe dy operacione të mëdha të përgjithshme: operacionin gjerman të Dimrit 1943-1944, që ndërmorën nazistët gjermanë me forca të Korpusit XXI e XXII Malor dhe 5.000 forca mercenare, si dhe operacionin gjerman të Qershorit 1944, e cila në fazën e dytë të saj i zhvendosi veprimet luftarake

në juridiksionin e Z1Op. Pranë shtabit të Z1Op gjatë luftës qëndruan dhe misionet ushtarake të vendeve të koalicionit antifashist botëror si anglezë dhe amerikanë.

Pas përballimit me sukses të operacionit të Qershorit 1944, komanda e Zonës, në bashkëpunim me brigada sulmuese, organizoi veprimet luftarake dhe çliroi qytetet e Gjirokastër, Delvinës, Vlorës e Fierit dhe krejt hapësirën e qarqeve e të krahinave që mbulonte ajo. Kështu Z1Op i plotësoi me nder dhe lavdi detyrat që iu ngarkuan. Z1Op zhvilloi veprimtarinë në krahinën gjeografike në Shqipërinë Jugperëndimore, me një sipërfaqe mbi 6.000 km². Përfshinte tërësisht rrethet Sarandë, Delvinë, Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Mallakastër dhe pjesërisht Fierin. Përbëhet kryesisht prej malesh me drejtim verijug, gryka, lugina e fusha. Rrugët e Shqipërisë Jugore ishin me rëndësi për pushtuesin, në pikëpamje ushtarake, sepse ndërmjet tyre bënin furnizimet, manovrimet, tërheqjen e forcave e të mjeteve, vendosjen e lidhjeve midis forcave të vetë e garnizoneve të shumta të shtrirë në zonë dhe në krahinat e deri në shtetin fqinj. Zona paraqet një teren tepër të përshtatshëm për lëvizje dhe manovrimet të formacioneve të lehta luftarake, sikurse ishin forcat partizane, për mbrojtje të manovruar, për prita dhe për t'u maskuar dhe si bazë nisjeje, për sulme të përgatitura mirë dhe me kujdes, për shpëputje kontakti luftarak, tërheqje të forcave etj. Para e në prag të krijimit të Z1Op në Shqipëri ishin krijuar e vepronin forca politike e organizata të ndryshme. Ndër më kryesoret ishin PKS (nëntor 1941) dhe BK (zyrtarisht doli në nëntor 1942). Këto forca politike kishin nisur të krijonin dhe forcat e tyre të armatosura, natyrisht të formacioneve të vogla, të shkallës taktike, si njësite guerile, çeta dhe deri batalione. Në qershor 1943, në këto qarqe filloi edhe procesi i krijimit të batalioneve partizane (b.p.), gjë që shënoi edhe shkallën më të lartë të organizimit ushtarak deri në këtë periudhë. Në qarkun e Vlorë vepronin 2 b.p. me efektivi 400 luftëtarë dhe në qarkun e Gjirokastër 2 b.p. me efektivi

600 luftëtarë. Vepronin dhe mjaft çeta partizane. Efektivi i forcave partizane arrinte në 2.000 luftëtarë. Por vepronin dhe 4.000 luftëtarë në batalionet territoriale në zona të lira, në njësitet guerile në qytete etj. Organizata e BK në Z1Op kishte krijuar çeta balliste. Formacionet luftarake të mësipërme ndërmorën edhe disa veprime luftarake të përmasave kryesisht të vogla e lokale, por ndonjëherë edhe të dimensioneve operative, tipike këto sidomos për forcat e LNÇ-it.

Në këtë periudhë u përsos taktika e përdorur gjatë veprimeve luftarake, si dhe u zgjeruan aksionet. Pritat dhe veprimet e befasishme në kushtet e inferioritetit në efektivi e armatim gjetën përdorim të suksesshëm. Disa veprime morën karakter sulmues, nisi të shfaqet bashkëveprimi midis çetave e batalioneve, por edhe midis forcave të qarqeve fqinje. Grupimi i disa forcave partizane dhe bashkëveprimi midis tyre realizoi disa detyra si: mbajtje nën kontroll të rrugëve; zënia e pritave në përmasa më të gjera, në hapësirë e kohë; veprime sulmuese kundër garnizoneve; mbrojtja e bazave partizane; organizimi i çetave e batalioneve partizane si dhe i atyre territoriale etj. Krijimi i Z1Op si një formacion i llojit të veçantë u kushtëzua nga: zgjerimi e ashpërsimi i goditjeve mbi armikun në qytete e në krahina të gjera; organizimi i operacioneve në shkallë më të gjerë dhe bashkëveprimi midis forcave të çetave e batalioneve partizane; krijimi i formacioneve më të mëdha luftarake grup, Br.S, më kompakte, me fuqi të madhe goditëse e deri i një ushtrie të organizuar e të rregullt për t'i bërë ballë armikut dhe për të realizuar qëllimin strategjik, çlirimin e vendit; domosdoshmëria e përsosjes së drejtimin të forcave partizane në kushtet e reja të zgjerimit të luftës në hapësirë, forma dhe objektiva. Në komandën dhe shtabin e Zonës u zgjodhën 11 anëtarë. Në këto funksione u emërtuan personalitete të spikatura e në moshë relativisht të pjekur. Në përzgjedhjen e tyre del se janë mbajtur parasysh disa kritere si: çdo krahinë të mbulohej me përfaqësues të vet; çdo anëtar i shtabit të gëzonte autoritet në veprimtarinë e vet antifashiste dhe luftarake, të gëzonte autoritet dhe mbështetje në popull; të kishte marrë pjesë më parë në luftërat e mëparshme të popullit shqiptar, të ishte i angazhuar politikisht dhe ushtarakisht në vitet e para të LNÇ-it; të ishin njerëz me formim të mirë ushtarak, me përvojë të pasur luftarake, pra drejtues dhe komandues.

Disa nga parimet mbi të cilat u mbështet puna dhe veprimtaria e vet shtabi të Zonës: drejtimi kolegjal ku dallojmë dy momente shtabi mblidhej në momente të caktuara, qëndrimi gati në çdo kohë bashkë i pjesës operative të shtabit si dhe komanda. Shtabi përbëhej nga: komandant, kapiten Islam Radovicka; komisar politik, toger Bedri Spahiu; zëvendëskomandant Hasan Pulo; zëvendëskomisar Hysni Kapo; oficeri i planeve, Jaho Gjolliku; ndihmës oficer i planeve Qazim Kondi; anëtar, Baba Fejzo, Rexhep Plaku, Nuredin Aliu, Hariz Velo dhe Fasli Jaho.





Vdes piloti që hodhi bomben atomike në Hiroshima Fatit nuk i mungon kurrë ironia...

Ditën e mërkurë, në datën 30 korrik 2014, në moshën 93 vjeçare, vdiq Theodore Van Kirk, piloti amerikan i cili lëshoi bombën atomike në Hiroshima. Ai ishte vetëm 24 vjeç kur kreu këtë mision, në 6 gusht të vitit 1945, kur në bordin e “B-29 Superfortress”, bashkë me 11 pjesëtarë të tjerë të ekuipazhit, lëshoi “Little Boy” (Djali i vogël – emri në kod i bombës atomike) mbi qytetin japonez. Van Kirk, i quajtur ndryshe nga ekuipazhi edhe si “holandezi”, ndërroi jetë në qytetin Georgia të SHBA. Në datën 6 gusht 1945 avioni Boeing B-29 Superfortress “Enola Gay”, i pilotuar nga Paul W. Tibbets, u nis nga zona e Tinian për në ishujt

Marianne, me dymbëdhjetë pjesëtarë në bord dhe me bombën atomike prodhuar nga projekti Manhattan. Në orën 08.15, avioni kishte arritur mbi Hiroshima, një qytet me rreth 350.000 persona. Lëshimi i “Little Boy” provokoi vdekjen e menjëhershme të rreth 78.000 personave dhe në fund të vitit 1945 numri të vdekurve kishte shkuar në 140.000. Është një ironi e fatit, që varrimi i Van Kirk do të bëhet në datën 5 gusht në Pensilvani, në datën përkujtimore të bombardimit të Hiroshimës. “Ne luftonim kundër një armiku që kishte reputacionin se nuk dorëzohej kurrë dhe nuk thyhej kurrë. Është vërtet e vështirë që të flitet për moral dhe luftë në të njëjtën fjali...” - do të thoshte dikur Van Kirk.



Para hedhjes së Bombës



Pas hedhjes së Bombës